

Në bazë të nenit 55 pika 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e R.M. „, nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) dhe në bazë të nenit 25 pika 2 dhe pika 5 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e R.M “ nr. 103/08, 33/2010, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12 dhe 24/13), si dhe në bazë të nenit 6 dhe nenit 7, pika 1, alineja 4 nga ligji i Byrosë për zhvillim të arsimit („Gazeta zyrtare e R.M “ nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13), ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi Programin mësimor, *Matematikë* për klasën e III në arsimin fillor nëntëvjeçar.

PROGRAMI MËSIMOR

# M A T E M A T I K Ë

për klasën e III-të

Arsimi fillor nëntëvjeçar

Shkup, shkurt 2014

## Hyrje

Programi arsimor nga matematika për klasën e tretë të arsimit fillor nëntëvjeçarë është marrë nga Qendra ndërkombëtare për programe mësimore (Cambridge International Examination) dhe adaptuar nga Byroja e zhvillimit të arsimit. Lejimi i përshtatjes të programit mësimor është marrë nga ekspertët e Qendrës ndërkombëtare për programe mësimore (Cambridge International Examination).

Programi mësimorë ngërthen përmban një përmbledhje qëllimesh arsimore zhvillimore nga lënda mësimore matematikë. Në to hollësisht përshkruhet çka nxënësi duhet të dijë ose çka duhet të bëjë në çdo vit të arsimit fillorë . Qëllimet arsimore përcaktojnë strukturë për mësim dhe udhëzim cilat aftësi dhe njohuri të nxënësit mund të provohen.

Programi mësimorë nga matematika është ndarë në pesë kapitla: Numrat /*Operacionet matematikore*, *Gjeometri*, *Matjet*, *Puna me të dhëna dhe zgjidhje e problemeve*. Katër kapitlat e para mbështeten me kapitlinë Zgjidhja e problemeve, ku janë përshkruar teknikat, aftësitë dhe zbatimi i njohurisë dhe strategjitë në zgjidhjen e problemeve. Strategjitë logjike janë, gjithashtu, pjesë kryesore në pjesën Numra Ky program mësimor fokusohet në parime, skema, sisteme, funksione dhe raporte ashtu që nxënësit mund ta realizojnë njohurinë matematikore dhe të zhvillojnë kuptim holistik për lëndën. Programi mësimorë nga matematika për klasën e tretë të arsimit fillorë jep bazë solide mbi të cilën mund të mbindërtohen fazat e mëtutjeshme të arsimit.

Programi mësimorë realizohet me fond prej 5 orë në javë, gjegjësisht 180 orë në vit.

Programi arsimor i Kembrixhit është ndërtuar në vlerat e Kembrixhit dhe në praktikën më të mire në shkolla. Ajo është përkushtuar të zhvillohen nënës të cilët do të bëhen të përgjegjshëm, kreativ dhe të angazhuar në mësim kreativ dhe aktiv.

Pjesët e programit mësimorë që i përkasin vlerësimit, kushteve hapësinore për realizim të mësimit dhe normativit për kuadrin arsimorë janë dhënë në përputhje me nenin 25 pika 5 nga Ligji për arsim fillorë.

# Programi mësimorë për klasën e III-të

## 1. Kaptina dhe rezultatet e pritura

### Numri

#### *Numrat dhe sistemet e numrave*

- Numëron prej 100 deri 200 e më shumë.
- Lexon dhe shkruan numra deri më së paku 1000.
- Numëron para dhe mbrapa njëshe, dhjetëshe dhe qindëshe, numra dyshifrorë dhe tre shifrore.
- Numëron para dhe mbrapa në hapa nga 2, nga 3, nga 4 dhe nga 5 deri së paku 50.
- Din çka paraqet secila shifër në numrin treshifrore dhe i zbërthen në qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe.
- Përcakton për 1, 10, 100 më shumë /më pak prej numrave dyshifrorë dhe treshifror.
- Shumëzon numra dyshifrorë me 10 dhe e kupton rezultatin.
- Rrumbullakon numra dyshifrorë deri te dhjetëshja më e afërt dhe numra treshifror deri te qindëshja më e afërt.
- E gjen vendin e numrit treshifror në vargun e numrave qindëshe.
- E gjen vendin e numrit treshifror në vargun e numrave qindëshe dhe dhjetëshe.
- Krahason numra treshifror duke i shfrytëzuar shenjat „>“ dhe „<“ dhe gjen numër ndërmjet tyre.
- Radhit numra dyshifrorë dhe treshifror.
- Bën vlerësim të kuptueshëm të një numri ndërmjet dhjetësheve (për shembull: prej 30 deri 50).
- Gjen gjysmën e numrave çift dhe tek deri 40 dhe i shënon, si për shembull:  $13 \frac{1}{2}$ .
- Kupton se thyesat janë pjesë të një tërësie dhe i shënon, si për shembull:  $\frac{3}{4}$  është tre të katërtat, e  $\frac{2}{3}$  është dy të tretat.
- Njeh barabarësinë ndërmjet thyesave  $\frac{1}{2}, \frac{2}{4}, \frac{4}{8}, \frac{5}{10}$  duke shfrytëzuar aktivitete dhe diagrame.
- Fillon ti lidhë thyesat me pjesëtimin në pjesë të barabarta (për shembull: pjesëtimi i picës në 4 pjesë të barabarta 4 personave ose ndarja e dy mollëve 4 personave).
- Gjen gjysma, të tretat, të katërtat dhe të dhjetat e formave dhe numrave natyrorë me shfrytëzim të manipuluese (për shembull, llogaritëse, guralecë).

## Operacionet matematikore

### *Strategjitë e të menduarit*

- I din faktet për mbledhje dhe zbritje për të gjithë numrat deri 20.
- I din faktet vijuese për mbledhje dhe zbritje:
  - Mbledh dhe zbret qindëshe deri 1000 ( $400+600=1000$ );
  - Mbledh dhe zbret numra dyshifrorë të cilët janë të pjesëtueshëm me 5 deri 100 ( $100-15=85$ ).
- E din tabelën e shumëzimit me 2, 3, 5 dhe 10.
- Fillon ta mësojë tabelën e shumëzimit me 4.
- Njeh numra dyshifrorë dhe treshifrorë të fituar me shumëzim me 2, 5 dhe 10.
- Shpejt i ndan numrat prej 1 deri 20 dhe numrat e fituar i ndan në gjysmë.
- Shpejt i dyfishon numrat të fituar me shumëzim me 5 (<100) dhe numrat e fituar i ndan në gjysmë (për shembull, e dyfishon numrin 15 ose e dyfishon numrin 45).
- Shpejt i dyfishon numrat e fituar me shumëzim me 50, prej 50 deri 500 (për shembull; e dyfishon numrin 150 ose e dyfishon numrin 450).

### *Mbledhja dhe zbritja*

- Mbledh dhe zbret numra dyshifrorë dhe treshifrorë me 10 dhe me dhjetëshe të plota (për shembull:  $570-40=530$ ).
- Mbledh numra treshifrorë me 100 dhe me qindëshe të plota (për shembull:  $460+200=660$ ).
- E shfrytëzon shenjen „=” për të treguar barazimin (për shembull:  $75 + 25 = 95 + 5$ ).
- Mbledh disa numra të vogël.
- Gjen mbledhësin e panjohur gjatë mbledhjes së numrave shuma e të cilëve është deri 100, me zgjidhje të barazimeve si (për shembull:  $78 + \quad = 100$ ).
- Mbledh dhe zbret çifte numrash dyshifrorë.
- Mbledhë numra treshifrorë dhe dyshifrorë me shënim.
- I rigrupon mbledhësit që ta lehtësojë mbledhjen (për shembull:  $38+17+33+62+7=38+62+17+33+7=100+50+7=157$ ).
- Mbledhë /zbret numra njëshifrorë me /nga numrat treshifrorë.
- Gjen për 20, 30,...90, 100, 200, 300 më të madh /numër më të vogël se numri treshifrorë.

### *Shumëzimi dhe pjesëtimi*

- E kupton raportin ndërmjet përgjysmimit dhe dyfishimit.
- E kupton rezultatin e shumëzimit të numrit dyshifrorë me 10.
- Shumëzon numra njëshifrorë dhe pjesëton numra dyshifrorë me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe 10.
- Shumëzon numra nga dhjetëshja e dytë me 3 dhe me 5.

- Fillon me pjesëtim të numrave dyshifrorë me numër njëshifrorë, herësi i të cilëve është pak më i madh se 10 (për shembull,  $60 : 5$  ose  $33:3$ ).
- Kupton se në pjesëtim mund të ketë mbetje (në fillim si „tepricë“).
- E kupton dhe e zbaton vetinë komutative të shumëzimit.
- E kupton raportin ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit dhe shënon shembuj.

## Gjeometri

### *Format dhe të menduarit gjeometrik*

- Njeh, përshkruan dhe vizaton 2D forma duke përfshi pesëkëndësha, gjashtëkëndësha, tetëkëndësha dhe gjysmërrathë.
- Dallon 2D forma sipas numrit të brinjëve, kulmeve dhe këndeve të drejtë.
- Njeh, përshkruan dhe bën 3D forma duke përfshi piramida dhe prizma; hulumton se si bahet kubi.
- Dallon 3D forma sipas numrit dhe llojit të brinjëve, numrit të kulmeve dhe teheve.
- Vizaton dhe realizon 2D forma me simetri refleksive dhe vizaton reflekse të formave (vijën e pasqyrës përgjatë një brinje).
- Lidh forma 2D dhe forma 3D me vizatime të të njëjtave.
- Njeh forma 2D dhe 3D, vija të simetrisë dhe kënde të drejta në rreth.
- Njeh kënde të drejta në 2D forma.

### Pozita dhe lëvizja

- Shfrytëzon koncepte adekuate që të tregojë pozitë, kahe dhe lëvizje, në kahe të shigjetave të orës dhe në kahe të kundërt me lëvizjen e akrepave të orës.
- E gjen dhe e përshkruan pozitën e katrorit në rrjetë të katrorëve ku rendet dhe kolonat janë të shënuara.
- Shfrytëzon katrorë që të vizatojë kënde të drejta.
- Krahason kënde me kënd të drejtë dhe njeh se dy kënde të drejta përcaktojnë drejtëz.

## Matjet

### *Paratë*

- Din të shfrytëzojë monedha dhe bankënota.
- Shfrytëzon fakte për mbledhje dhe zbritje deri 100 që ta llogarit kusurin.

### *Gjatësia, masa dhe vëllimi*

- Zgjedh dhe shfrytëzon njësi përkatëse dhe instrumente për vlerësim, matje dhe shënim të rezultateve nga matjet.
- E din raportin mes kilometrave dhe metrave, metra e centimetra, kilogram e gram, litra dhe mililitra

(për shembull:  $1 \text{ km} = 1000 \text{ m}$ ).

- E lexon ndarjen më të afërt, duke shfrytëzuar instrumente për matje të numëruar ose gjysmë të numëruar.
- Shfrytëzon vizor të vizatojë dhe matë vijat deri te centimetri më afërt.
- Zgjidh problem tekstuale në të cilat janë përfshirë matjet.

### *Koha*

- Propozon dhe shfrytëzon njësi përkatëse për matje të kohës dhe e din raportin ndërmjet tyre (sekondë, minutë, orë, ditë, javë, muaj, vit).
- E lexon kohën e orëve analogjike dhe orëve digjitale, deri më së afërmi 5 minuta në orë analoge dhe minute më të afërt të orës digjitale.
- Fillon të njehsojë interval kohore të thjeshta në orë dhe minuta.
- Lexon kalendarë dhe njehson interval kohore në javë ose ditë.

### **Puna me të dhëna**

#### *Organizimi, kategorizimi dhe paraqitja e të dhënave*

- Përgjigjet në pyetjet nga përditshmëria me mbledhje, organizim dhe interpretim I të dhënave (p. shembull: hulumtimi i populacionit, i llojeve të insekteve në mese të ndryshme).
- Shfrytëzon tabela për shpesh, piktograme (simbole të cilat paraqesin një ose dy njësi) dhe diagrame shtyllore.
- Shfrytëzon diagram të Venit ose Karollovit të grumbulloj të dhëna dhe objekte sipas dy kritereve.

### **Zgjidhje e problemeve**

#### *Shfrytëzimi i teknikave dhe aftësive në zgjidhje të problemeve matematikore*

- Zgjedh dhe zbaton strategji përkatëse mendore për njehsim.
- Fillon ti kuptojë njësitë matëse për gjatësi, peshë, vëllim dhe kohë dhe ti shfrytëzojë të bëjë matje përkatëse.
- I kupton dhe i zgjedh detyrat tekstuale të thjeshta (me njërin nga katër operacionet) dhe operacione në dy etapa (mbledhje dhe zbritje) dhe fillon ti tregojë, për shembull: me vizatime ose me shënim të shprehjeve.
- I provon rezultatet nga mbledhja e dy numrave duke shfrytëzuar zbritje dhe në mbledhjen e disa numrave me ndërrim të vendeve mbledhësve.
- E provon zbritjen me mbledhje.
- E shfrytëzon vetinë komutative të shumëzimit që ta provojë rezultatin nga shumëzimi, për shembull: provon se  $6 \cdot 4 = 24$  me shumëzim  $4 \cdot 6$ .
- E provon pjesëtimin me ndihmën e shumëzimit, për shembull:  $12 : 4 = 3$  sepse  $3 \cdot 4 = 12$ .
- E njeh raportin ndërmjet formave 2D të ndryshme.

- I njeh dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet formave 3D të ndryshme.
- Vlerëson dhe e përcakton vlerën e përafërt dhe e provon rezultatin.
- Bën vlerësim të kuptueshëm të përgjigjes, për shembull. Me rrumbullakim.
- Tregon a është përgjigja e arsyeshme.

### *Shfrytëzimi i të kuptuarit dhe strategjitë në zgjidhjen e problemeve*

- Paramendon tregim për detyrën e parashtruar, duke i përfshi në atë kontest edhe paratë.
- E sqaron zgjedhjen e strategjisë për zgjidhjen e problemit dhe tregon se si ka arritur deri te rezultati.
- Analizon dhe zgjidh problem situatash dhe detyra, për shembull: probleme logjike.
- Shfrytëzon lista dhe tabela për zgjidhje sistemore të problemeve.
- Përshkruan dhe vazhdon vargje me numërim para dhe mbrapa në hapa nga 2, nga 3, nga 4, nga 5, nga 10 dhe nga 100.
- Njeh raporte të thjeshta ndërmjet numrave, (për shembull: secili numër është për tre më I madh se ndonjë numër që është para tij, duke filluar nga numri 4).
- Njeh raporte të thjeshta ndërmjet formave (për shembull: disa forma të dhëna kanë numër të njëjtë vijave të simetrisë).
- Analizon gjykim të thjeshtë me gjetjen e shembujve që e vërtetojnë ose nuk e vërtetojnë të njëjtën (kur numrit treshifrorë i shtohet 10 shifra e parë nuk ndryshon).
- Me gojë e sqaron mënyrën e zgjedhjes dhe të menduarit, duke i përfshi edhe të menduarat fillestare për përgjigjet e mundshme të problemit.



## 2. Objektivat konkrete, aktivitetet dhe mjetet për punë

Temat nga programi mësimorë janë dhënë me shembuj të aktiviteteve nëpërmjet të cilave mund të arrihen, si dhe me materiale të nevojshme për realizimin e tyre. Secila temë realizohet në etapa dhe zhvillohet në tre periudha gjatë vitit shkollor (1A, 2A, 3A, 1B, 2B, 3B, 1C, 2C, 3C) për shkak të qasjes spirale në planifikimin dhe realizimin e mësimit të matematikës. Qasja spirale mundëson në procesin e mësimit të fillohet me atë që nxënësit e dinë dhe gradualisht të ndërtohet dhe zgjerohet njohuria e nxënësve.

Periudha 1	Periudha 2	Periudha 3
1A Numri dhe zgjidhja e problemeve	2A Numri dhe zgjidhja e problemeve	3A Numri dhe zgjidhja e problemeve
1B Gjeometria dhe zgjidhja e problemeve	2B Matje dhe zgjidhja e problemeve	3B Gjeometria dhe zgjidhja e problemeve
1C Matje dhe zgjidhja e problemeve	2C Puna me të dhëna dhe zgjidhja e problemeve	3C Matje dhe zgjidhja e problemeve

## 1A: Numri dhe zgjidhja e problemeve

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe material)	Komente
<p><b>Numrat dhe sistemi i numrave</b></p> <p>Numëron prej 100 deri 200 dhe më shumë.</p> <p>Lexon dhe shkruan numra më së paku deri 1000.</p> <p>Numëron para dhe pas në etapa nga 2, nga 3, nga 4 dhe nga 5 deri më së paku 50.</p> <p>Gjen vendin e numrit treshifrorë në vargun numerik të qindësheve.</p> <p>Gjen vendin e numrit treshifrorë në vargun numerik të qindësheve dhe dhjetësheve.</p> <p>Numëron para dhe pas njëshe, dhjetëshe e qindëshe, numra dyshifrorë dhe treshifrorë.</p>	<p>Nxënësit në paralele numërojnë me radhë deri 100, deri 200 dhe më tutje.</p> <p>Në paralele lexojnë numra dhe parashtrohen pyetje të kahëzuara.</p> <p>Numërojnë në paralele.</p> <p>Demonstrim i aktivitetit nga arsimtari. Aktivitet në çifte: secili në çift tre here gjuan kubin prej 1-6. Përpilon numër prej 3 shifrave dhe e vendos në varg të numrave.</p> <p>Demonstrim i aktivitetit nga arsimtari.. Aktivitet në çifte: secili në çift tre here gjuan kubin prej 1-6. Përpilon numër prej 3 shifrave dhe e vendos në varg të numrave</p> <p>Numërojnë në paralele.</p> <p>Shfrytëzim I letrave për vendosje të shifrave, përfitim të numrit treshifrorë dhe shënim i qindësheve, dhjetësheve dhe njësheve.</p>	<p>Katrore me numra deri 100, deri 200.</p> <p>Letra të mëdha me numra treshifrorë.</p> <p>Tabela „qindëshe“, varg me numra.</p> <p>Kubi prej 1-6, varg I numrave.</p> <p>Kubi prej 1-6, varg me numra.</p> <p>Tabela „qindëshe“, letra për vendosje të numrit.</p> <p>Letra për shënim të shifrave.</p>	<p>Gjithashtu shfrytëzoni edhe më pak letra për nxënësit me përkrahje.</p> <p>Më pak katrorë dhe vargje me numra për nxënësit për punë në bankë me përkrahje të arsimtarit.</p> <p>Tabela më të vogla qindëshe për nxënësit për punë në banka me përkrahje nga arsimtari.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe material)	Komente
<p>Din çka paraqet secila shifër në numrat treshifrorë dhe l zberthen në qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe.</p> <p>Përcakton për 1, 10, 100 më shumë /më pak nga numrat dyshifrorë dhe treshifrorë.</p> <p><b>Operacionet matematikore Strategjitë e të menduarit</b></p> <p>I din faktet për mbledhje dhe zbritje për gjithë numrat deri 20.</p> <p>I din faktet vijuese për mbledhje dhe zbritje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbledh dhe zbret qindëshe deri 1000 (<math>400+600=1000</math>);</li> <li>- Mbledh dhe zbret numra dyshifrorë të cilët janë të pjesëtueshëm me 5 deri 100 (<math>100-15=85</math>).</li> </ul> <p>E din tabelën për shumëzim me 2, 3, 5 dhe 10.</p>	<p>Vendosje e paraleles së tërë dhe ndarja e nxënësve në grupe sipas aftësive.</p> <p>Nxënësit përgjigjen në pyetje: Sa duhet të shtojmë? <i>Sa duhet të zbresim?</i></p> <p>Nxënësit përgjigjen në pyetje: Sa duhet të shtojmë? <i>Sa duhet të zbresim?</i></p> <p>Ushtrim me gjithë paralelen, e përcjellë me lojë në çifte: Secili me radhë gjuan kub e shënuar me numrat 2, 3, 3, 5, 5, 10.</p> <p>Në katrorë deri 100, mbuloni cilindo shumëzues të numrit të treguar.</p> <p>Ushtrime me gjithë paralelen, e përcjellë me lojë në të cilën do të zbatohet tabela „qindëshe“, njehsorë (zhetonë) dhe letra.</p> <p>Ushtrime me gjithë paralelen. Shfrytëzoni tabelën „qindëshe“ që ta</p>	<p>Tabela qindëshe. Njehsorë (zhetonë) dhe kube.</p> <p>Njehsore (zhetonë) (zhetonë) ose kube duhet të jenë të përshtatshme për nxënës të cilëve u nevojitet përkrahja më e madhe.</p> <p>Rrjete me numra.</p> <p>Nga një kub për çift e shënuar me 2, 3, 3, 5, 5, 10; tabela „qindëshe“; zhetonë me ngjyrë të ndryshme për çdo lojtarë në një çift.</p> <p>Tabela „qindëshe“, njehsorë (zhetonë), paket letra me numra 0 – 40 për çdo çift.</p>	<p>Rrjetë në banka për nxënës të cilëve nuk u nevojitet përkrahja.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe material)	Komente
<p>Fillon ta mësojë tabelën e shumëzimit me 4.</p> <p>Njih numra dyshifrorë dhe treshifrorë të fituar me shumëzim me 2, 5 dhe 10.</p> <p><b>Mbledhja dhe zbritja</b> Mbledh dhe zbret numra dyshifrorë dhe treshifrorë me 10 dhe me dhjetëshe të plota (shembull. 570-40=530).</p>	<p>shihni vargun e numrave të cilat I përmbajnë numrat 2, 5 ose 10. Pastaj, shfrytëzoni tabelën „qindëshe “e cila fillon nga 0 deri 100 dhe vazhdoni me vargun e numrave të cilët I përmbajnë 2, 5 ose 10.</p> <p>Nxënësit le të punojnë në çifte. Shfrytëzoni kub të shënuar me numrat 2, 2, 5, 5, 10, 10. Secili le të gjuajë me rend dhe le të mbulojë cilindro numër në tabelë „qindëshe “ që i përmban numrat 2, 5 ose 10.</p> <p>Demonstroni nxënësve: Mbulojeni numrin fillestarë nga tabela „qindëshe “ me zheton. Hedhim dy kube, njëra është shënuar me + dhe -, tjetra e shënuar me numrat që e përmbajnë 10. Nëse në kubin e pare që e keni hedhur është +, e në të dytën 20, dmth., për 20 e zhvendosni zhetonin nga numri fillestarë. Duke punuar në çifte, të gjithë me radhë hidhni kubet dhe zhvendosni zhetonin tuaj.</p> <p>Udhëzoni nxënësit me zbatim të letrave për vendosje të shifrave. Bëni numër prej tre shifrave, shtoni qindëshe të plotë. Pyetni nxënësit: Cila letër ndërrohet? Pastaj nxënësit ndërmjet veti parashirojnë detyra për mbledhje të numrave treshifrorë me qindëshe të plota.</p> <p>Shfrytëzoni kub që të fitoni numra dyshifrorë dhe treshifrorë të cilët mund</p>	<p>Katror deri 100, katrorë prej 101 deri 200, kub të shënuar, njehsorë (zhetonë) ose kube.</p> <p>Tabelë të madhe „qindëshe “ për demonstrim, tabelë „qindëshe “ për çdo nxënës, nga dy kube të shënuara me 2, 2, 5, 5, 10, 10 për çdo çift dhe njehsorë (zhetonë).</p> <p>Tabelë të madhe „qindëshe “ për demonstrim, tabelë „qindëshe “ për çdo nxënës, dy kube të shënuara në çift nxënës, njehsorë (zhetonë).</p> <p>Letra për vendosje të shifrave.</p>	<p>Disa nxënësve ndoshta do të u nevojiten më shumë ushtrime me përdorim të kalkulatorit para se të fillojnë me këtë aktivitet.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe material)	Komente
<p>Mbledh numër treshifrorë me 100 dhe me qindëshe të plota (shembull: <math>460+200=660</math>).</p> <p>E shfrytëzon shenjën „=” për të treguar barazim (shembull: <math>75 + 25 = 95 + 5</math>).</p> <p>Mbledh disa numra të vegjël.</p> <p><b>Shumëzimi dhe pjesëtimi</b></p> <p>E kupton raportin ndërmjet përgjysmim dhe dyfishim.</p>	<p>të mblidhen. Shënoni detyrë me mbledhje për përdorim të shenjës „ = “ (për shembull: <math>75 + 25 = 95 + 5</math>).</p> <p>Nxënësit le të punojnë në çifte, Secili lojtarë nga çifti hedh përkatësisht kub të shënuar 3 ose 4 herë. Partneri le ti shënojë numrat, i radhit dhe i mbledh.</p> <p>Lojë „Shitje në gjysmë çmimi “: Mësimdhënësi tregon çmime nga shitorja. Fillon interesoni mësimdhënësnxënës: Sa do të jetë çmimi nëse ka shitje në gjysmë të çmimit? <i>Çka nëse blejmë 2 artikuj me gjysmë çmim?</i> Pastaj nxënësit mendojnë etiketa për çmime të veta para dhe pas shitjes.</p> <p>Me përdorje të llogaritësit (kalkulatorit ), kërkoni nga nxënësit të vendosin numër dyshifrorë në ekran, të shtypin x dhe pastaj të shtypin 10. Parashtroni pyetje me qëllim që vet të vijnë deri te rregulla për shumëzim të numrit dyshifrorë me 10, për shembull. <i>Çka ndodh? Përsëritni me numër të rinj. A do të ndodhë çdo here kjo? A mund të mendojmë rregull për shumëzim me 10?</i></p>	<p>Kubi.</p> <p>Kubi.</p> <p>Etiketa (flet shënime) për çmim para dhe pas shitjes.</p> <p>Letra me pyetje ‘çka nëse’.</p> <p>Llogaritës (kalkulator).</p>	<p>Disa nxënës ndoshta do të duhet prej ma pare të ushtrojnë aftësi për punë me llogaritës (kalkulator).</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe material)	Komente
<p>E kupton rezultatin nga shumëzimi të numrave dyshifrorë me 10.</p> <p>E kupton dhe zbaton vetinë komutative të shumëzimit.</p>	<p>Kërkoni me përdorim të llogaritësit, nxënësit të hulumtojnë: Vendosi numër njëshifrorë dhe shumëzoni me numër tjetër njëshifrorë, shtypni =. Shënojeni procesin. Përsëriteni vendosjen e numrave por në radhitje të kundërt. Filloni me diskutim: <i>çka ndodhë? Çka vëreni? A do të ndodhë gjithmonë e njëjta?</i></p>	<p>Llogaritës (kalkulator)</p>	
Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p><b>Zgjidhje e problemit</b> Zbatim I teknikave dhe aftësive në zgjidhjen e problemeve matematikore.</p> <p><b>Zgjedh dhe zbaton strategji përkatëse të të menduarit për njehsim.</b></p> <p><b>I zgjedh dhe I zgjidh detyrat e thjeshta tekstuale (me njërën nga katër operacionet) dhe operacione në dy etapa (mbledhje dhe zbritje)</b></p>	<p>Gjatë punës në nivel të paraleles kërkoni të jepet sqarim për strategjitë e përdorura.</p> <p>Me përdorim të tre kubeve 1-6, sa gjithsej shuma të ndryshme mund të fitoni? Çka nëse do të përdornit kub tjetër?</p>	<p>Kub.</p> <p>Kubi.</p>	

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe material)	Komente
<p>dhe fillon ti tregojë, p. shembull: me vizatime ose shënim të shprehjeve.</p> <p><b>I provon rezultatet nga mbledhja e dy numrave duke shfrytëzuar zbritjen edhe të mbledhjes të disa numrave me ndërrim të vendeve të mbledhësve.</b></p> <p><b>E provon zbritjen me mbledhje.</b></p> <p><b>Përdëfton vallë është përgjigja e arsyeshme.</b></p> <p><b>Zbatim I të kuptuarit dhe strategji në zgjidhjen e problemeve</b></p> <p><b>Përpilon tregim nga numër të dhënë që të fillojë me njehsim.</b></p>	<p>Demonstrim nga arsimtari. Shfrytëzoni kub prej 1-6 që të fitoni dy numra njëshifrorë. Mblidhni ata. mblidhni ata në radhitje të ndryshme. Çka vëreni? Demonstroni disa shembuj, e pastaj leni nxënësit me hedhje të kubit të fitojnë numrat e tyre.</p> <p>Demonstrim nga arsimtari: Shfrytëzoni kub 1-6 që të fitoni dy numra njëshifrorë. Zbriteni numrin më të vogël nga numri më i madh. Provoni me mbledhje të numrit të fituar (rezultati) me numrin më të vogël. Vazhdoni me fitim të numrave dyshifrorë dhe treshifrorë. Lëni nxënësit me hedhje të kubit të fitojnë numër të vetin.</p> <p>Kërkohet nga nxënësit të mendojnë a është i arsyeshëm një përgjigje në kuadër të njësisë mësimore për njehsim.</p> <p>Nxënësit punojnë në çifte. Me hedhje të kubit fitojnë numra njëshifrorë, dyshifrorë ose treshifrorë si dhe shenjat „+“ „-“ „·“ „:“ ose „:“. Duke punuar bashkë mendojnë, mendojnë tregim që</p>	<p>Kubi.</p> <p>Llogaritës për disa nxënës.</p>	

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe material)	Komente
<p><b>E sqaron zgjedhjen e strategjisë për zgjedhjen e problemit dhe tregon se si ka arritur deri te rezultati.</b></p> <p><b>Analizon dhe zgjidh situata problemore dhe detyra, për shembull: problem logjike.</b></p> <p><b>Përshkruan dhe vazhdon vargje me numërim para ose pas në etapa nga 2, nga 3, nga 4, nga 5, nga 10 dhe nga 100.</b></p> <p><b>Njeh raporte të thjeshta ndërmjet numrave, (për shembull: secili numër është për tre më madh nga një numër që është para tij, duke filluar nga numri 4).</b></p>	<p>të vazhdojnë me njehsim.</p> <p>Të shfrytëzohet në kuadër të njësive mësimore për njehsim.</p> <p>Me shfrytëzim të 2, 4 dhe 5, dhe „+“, „·“ dhe barazi „=“, sa përgjigje të ndryshme mund të fitoni ndërmjet 40 dhe 400? Si do të dini se I keni të gjitha përgjigjet?</p> <p>Të shfrytëzohet në kuadër të njësive mësimore tabela „qindëshe“ ose vargu I numrave.</p> <p>Të shfrytëzohet në kuadër të njësive mësimore për vargun e numrave ose operacionet zbritje dhe pjesëtim si operacione inverse.</p>	<p>Tabela „qindëshe“. Vargu i numrave.</p> <p>Vargu i numrave.</p>	



## 1B: Gjeometri dhe zgjedhje e problemeve

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p><b>Gjeometri</b></p> <p>Njeh, përshkruan dhe vizaton 2D forma duke përfshi pesëkëndëshe, gjashtëkëndëshe, tetëkëndëshe dhe gjysmërreth.</p> <p>Dallon 2D forma sipas numrit të faqeve, teheve dhe këndeve të drejta.</p> <p>Njeh, përshkruan dhe bën 3D forma duke i përfshirë piramidat dhe prizmat; hulumton si bëhet kubi.</p> <p>Dallon 3D forma sipas llojit dhe numrit të kulmeve dhe teheve.</p>	<p>Shfrytëzoni përmbledhje prej 2D forma që të përvetësohen vetit e tyre dhe nxënësit të klasifikojnë sipas vetive të dhëna.</p> <p>Nxënësit klasifikojnë komplet prej 2D forma dhe i tregojnë në diagram të Venit ose Kerolovit , sipas vetive si për shembull, sipas numrit të faqeve, a ka kënd të drejtë, a ka vijë të simetrisë etj.</p> <p>Kërkoni nxënësit të bëjnë lidhje të 3D formave me emrin e tyre. Kërkoni shembuj të 3D formave në rrethinë. Nga rrjeti i dhënë nxënësit bëjnë 3D forma dhe i emërtojnë.</p> <p>Sipas vetive klasifikon 3D forma për shembull: a janë ose nuk janë prizma, numër l mureve anësore, tehe ose brinjë. Keni parasysh se prizma ka prerje të tërthortë të njëjtë përgjatë lartësisë së vet dhe shumëkëndëshat e saj paralel përputhen. Kërkoni gjithashtu nxënësit ti emërtojnë dhe shënojnë trupat e ngurtë.</p>	<p>2D forma.</p> <p>2D forma, i përgatitur diagram i Venit dhe /ose diagram i Kerolovit.</p> <p>Përmbledhje e 3D forma. Kartuç me emra të formave 3D.</p> <p>Firma me emra.</p>	<p>Cila do formë e cila ka lartësi është 3D, ashtu që për aktivitete me 2D forma, orientohuni sipas formës së fytyrës (faqja e parë e 3D formës).</p> <p>Nga shtëpia të sjellën gjësende si kuti ose konserva.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Vizaton dhe realizon 2D forma me simetri refleksive dhe vizaton reflekse të formave (vijë të pasqyrës përgjatë një brinje).</p> <p>Lidh 2D forma dhe 3D forma me vizatime të tyre.</p> <p>Njih 2D dhe 3D forma, vija të simetrisë dhe kënde të drejta në rrethinë.</p> <p>Njih kënde të drejta në 2D forma.</p> <p>Shfrytëzon koncepte përkatëse që të tregojë pozitën, kahe dhe lëvizje, në kahe të akrepave të orës dhe në</p>	<p>Shfrytëzim 2D forma me lakim dhe prerje ti caktojnë vijat e simetrisë. Shfrytëzoni pasqyra që të gjendet dhe përshkruhet reflektimi I formave. Luani me nxënësit lojën 'PERPUTHJE'. Shfrytëzoni dy komplete të letrave, në njërin ka 2D forma ose pjesë të tyre, e në tjetrën reflektimet e tyre.</p> <p>Luani me nxënësit lojën „PERPUTHJE”. Zgjidhet nga një letër nga secili komplet dhe bashkohen. Gjeneroni dhe krahasoni forma në paralele, shkollë dhe rreth.</p> <p>Klasifikoni me nxënësit komplet nga format. Tregoni në diagram të Venit ose diagram Kerolovit. Kriteria të mundshme: trekëndësh, katërkëndësh, pesëkëndësh etj. (të rregullt dhe jo të rregullt), kënd I drejtë, nuk ka kënd të drejtë.</p> <p>Shfrytëzoni, lexoni dhe zgjeroni fjalorin nga viti I kaluar. Përshkruani dhe gjeneroni pozitën e katrorit, në rrjetë prej katrorëve në të cilin janë shënuar rende dhe kolona.</p>	<p>2D forma, letra, gërshërë, pasqyrë.</p> <p>Dy komplete letra, njërin me forma, e tjetrin komplet me emra të formave.</p> <p>Komplet prej 2D forma. Të përgatitur diagram të Venit ose Kerolovit.</p>	

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
kahe të kundërt të akrepave të orës.	Luani me nxënës lojëa: „Iks-pikë“, „Kërkim i pasurisë“, „Nëndetësja“.	Bëni rrjetë në letër.  Rrjetë për lojërat: „Iks -pikë“, „Kërkesë pas pasurisë“, „Nëndetësja“.	

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p><b>Zgjidhje e problemeve</b></p> <p>E një raportin ndërmjet formave 2D të ndryshme.</p> <p>I një dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet formave të ndryshme 3D.</p> <p>Një raporte të thjeshta ndërmjet formave (për shembull: disa forma të dhëna kanë numër të njëjtë vija të simetrisë).</p>	<p>Shfrytëzoni përmbledhje prej 2D formave. Nxënësit zgjedhin forma sipas vetive që u keni treguar më herët.</p> <p>Shfrytëzoni përmbledhje prej 3D formave. Nxënësit zgjedhin forma sipas vetive që u keni treguar më herët.</p> <p>Vizatoni foton 2D formës së thjeshtë ndaj një tehu që e keni zgjedhë si vijë të simetrisë. Kërkoni nxënësit të mendojnë për: Sa 2D forma mund të gjinden me 1 vijë të simetrisë? Dalloni dhe vizatoni forma të cilat kanë 2 vija të simetrisë. Zbuloni forma me më shumë se 2 vija të simetrisë.</p>	<p>Forma 2D. Letra me veti.</p> <p>Forma 3D. Letra me veti.</p> <p>Forma 2D. Pasqyra.</p>	<p>Derisa nxënësit punojnë në aktivitete praktike, dëgjoni dhe vështroni. A shfrytëzojnë fjalor të saktë matematikorë? Këto aktivitete mund të shfrytëzohen si vegël për vlerësim.</p>

## 1C Matje dhe zgjidhje e problemeve

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p><b>Matje</b></p> <p>Din të shfrytëzojë monedha dhe bankënota</p> <p>Shfrytëzon fakte nga mbledhja dhe zbritja deri 100 që ta llogarit kusurin.</p> <p>Zgjedh dhe shfrytëzon njësi përkatëse dhe instrumente për vlerësim, matje dhe shënim të rezultatit nga matja.</p> <p>E din raportin ndërmjet kilometrave dhe metrave, metrave dhe centimetrave, kilogramëve dhe gramëve, litra dhe mililitra (për shembull: 1 km = 1000 m).</p> <p>E lexon ndarjen më të afërt, duke shfrytëzuar instrumente matjeje të numëruar ose pjesërisht të numëruar.</p>	<p>Njohje e vlerave të monedha dhe bankënotave dhe ndërrim të bankënotave me monedha ekuivalente.</p> <p>Shfrytëzim i strategjive vetjake për mbledhje dhe zbritje gjatë zgjidhjes së detyrave me të holla.</p> <p>Vlerësim, e pastaj provë me zbatim të njësive përkatëse: Sa është i gjerë /i lartë? Sa është l gjatë /l trashë? Sa nxë një enë e madhe? Sa kilogram peshon një tullë? Sa është larg një gotë /dru?</p> <p>Propozoni nxënësve gjësende të cilat mund më së miri të maten në metra; gram ose kilogram; litra ose mililitra.</p> <p>Cila gjatësi është treguar? Çfarë matje është treguar në shkallë? Sa ka në bokall? Shënoni matje me zbatim të përzierjes të njësive. Shënoni për afërsisht deri në gjysmë metër, gjysmë kilogram ose gjysmë litër me zbatim të njësive të plota ose gjysmë njësive.</p>	<p>Monedha dhe bankënota.</p> <p>Monedha dhe bankënota.</p> <p>Zgjedhje e lire e resurseve për matje.</p> <p>Lista të përgatitura me masa të shënuara.</p>	<p>Shfrytëzim i monedhave dhe bankënotave të vërteta kur mundet</p> <p>Dëgjoni dhe hulumtoni për kohën e aktiviteteve praktike. Ajo mund të shfrytëzohet si vegël për vlerësim.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Shfrytëzon vizor të vizatojë dhe mate vija deri te centimetri më l afërt.</p> <p>Zgjidh detyra tekstuale në të cilat janë përfshi matjet.</p> <p>Propozon dhe shfrytëzon njësi përkatëse për matje të kohës dhe e din raportin ndërmjet tyre (sekondë, minutë, orë, ditë, javë, muaj, vit).</p> <p>E lexon kohën e analogjive dhe orëve digjitale, deri më së afërmi 5 minuta në orë analoge dhe minutë më të afërt të orës digjitale.</p>	<p>Matni gjësende të ndryshme në klasë.</p> <p>Shfrytëzoni strategji të të menduarit për bërje të llogarive gjatë zgjidhjes së problemeve me matje të dhëna në konteste të ndryshme.</p> <p>Shfrytëzoni strategji të të menduarit për njehsim me të cilat do të zgjidhni problem me matje, të vendosur në konteste të ndryshme..</p> <p>Luani „Përputhje“ me shfrytëzim të dy kompleteve të letrave, njërin me kohë të dhënë në orë analoge dhe digjitale dhe tjetrën me kohë të shënuar me fjalë dhe numra.</p>	<p>Mjete nga jeta e përditshme si dhe disa fleta të përgatitura.</p> <p>Orë për ata që u nevojitet përkrahje më e madhe.</p> <p>Dy komplete letra.</p>	

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p><b>Zgjidhje e problemeve</b> Zgjedh dhe zbaton strategji përkatëse të të menduarit për njehsim.</p> <p>Fillon ti kuptojë njësitë për matje për gjatësi, peshë, vëllim dhe kohë dhe i shfrytëzon të kryejë matje përkatëse.</p>	<p>Shfrytëzoni mbledhje dhe zbritje dhe strategji individuale për zgjidhje probleme me të holla. Me gojë sqaroni metoda dhe shkaqe edhe atje ku është adekuate, shënoni fjali me numra që të tregoni si ka qenë l zgjidhur problem.</p> <p>Bëni vlerësim dhe prove për kohë të caktuar. Kërkoni nxënësit të propozojnë njësi përkatëse për matje të kohës ose njësi përkatëse me qëllim të zgjedhin problem të dhëna.</p>	<p>Monedha dhe bankënota.</p> <p>Mjete për matje.</p>	<p>Informata kthyesë mund të jetë për tërë paralelen, grupi ose çiftet.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Vlerëson dhe përcakton vlerën e përafërt dhe e provon rezultatin.</p> <p>Bën vlerësim të arsyeshëm të përgjigjes, për shembull. Me rrumbullakim.</p> <p>Përcakton a është e arsyeshme përgjigja.</p> <p>Paramendon tregim për detyrën e parashtruar, duke i përfshi në atë kontest edhe të hollat.</p> <p>E sqaron zgjedhjen e strategjisë për zgjedhje të problemit dhe tregon si ka arritur deri te rezultati.</p>	<p>Kërkoni nxënësit me gojë të sqarojnë si kanë menduar dhe si kanë gjetë zgjidhje, dhe aty ku mundet, le të shënojnë me numra (abstrakt) që të tregojnë si e kanë zgjidhë problemin.</p> <p>Vlerësim, e pastaj provë me zbatim të njësive përkatëse: Sa është i gjerë /lartë? Sa është i gjatë /I trashë? Sa nxë një enë e madhe? Sa kilogram peshon një tullë? Sa është larg një gotë /dru? Zgjidhni problem nga përditshmëria me shfrytëzim të të gjitha llojeve të masave. Shfrytëzoni metoda tuaja që të nxitni diskutime në nivel të paraleles ose në grupe.</p> <p>Zgjidhni problem: çka të blihet dhe si të paguhet.</p> <p>Shfrytëzoni strategji të të menduarit për njësim gjatë zgjidhjes së problemeve nga tema matje në numër të konsiderueshëm kontestesh. Diskutoni në nivel të paraleles ose grupit.</p>	<p>Mjete për matje.</p> <p>Mjete për matje.</p> <p>Monedha dhe bankënota</p>	<p>Informatë kthyesë mund të jetë për tërë paralelen, grup ose çifte.</p> <p>Informatë kthyesë mund të jetë për tërë paralelen, grup ose çifte.</p>

## 2A: Numri dhe zgjidhja e problemeve

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p><b>Numra dhe sisteme të numrave</b></p> <p>Numëron para dhe pas në etapa nga 2, nga 3, nga 4 dhe nga 5 deri më së pakti 50.</p> <p>Gjen vendin e numrit treshifrorë në varg numerik të qindësheve</p> <p>Gjen vendin e numrit treshifrorë në varg numerik të qindësheve dhe dhjetësheve.</p> <p>Numëron para dhe pas njëshe, dhjetëshe dhe qindëshe, numra dyshifrorë dhe treshifrorë.</p> <p>Din çka paraqet secila shifër në numrin treshifrorë dhe i zbërthen në qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe.</p> <p>Cakton për 1, 10, 100 më shumë /më pak nga numrat dyshifrorë dhe treshifrorë.</p>	<p>Nxënësit numërojnë në nivel të paraleles.</p> <p>Aktiviteti të realizohet në fillim të nivelit të paraleles. Kur do të ketë siguri më të madhe të nxënësit le të punojnë individualisht ose në çifte.</p> <p>Aktiviteti të realizohet në fillim të nivelit të paraleles. Kur do të ketë siguri më të madhe të nxënësit le të punojnë individualisht ose në çifte.</p> <p>Numëroni në nivel të paraleles me vendosje të pyetjeve të kahëzuara.</p> <p>Shfrytëzoni harta të mëdha për vendosje të vlerës për demonstrim para gjithë paraleles.</p> <p>Tregoni tabelë të madhe për vendosje të hartave, me qëllim që të ndërrohen shifrat: Bëni 10 më shumë; Bëni 100 më pak.</p> <p>Tregoni tabelë të madhe për vendosje të letrave. Vëreni dhe tregoni'. Çka</p>	<p>Tabela „qindëshe “.</p> <p>Shkop me numra të ngjitur numërim.</p> <p>Varg të numrave.</p> <p>Varg i madh numerik i qindësheve</p> <p>Vargje numerike të qindësheve për punë në banka.</p> <p>Numra të vegjël dhe të mëdhenj treshifrorë.</p> <p>Varg i madh me numra i shënuar me qindëshe të plota dhe dhjetëshe. Varg i vogël i numrave në tavolinë. Numra të mëdhenj dhe të vogël treshifrorë.</p> <p>Shkop me numra.</p> <p>Varg me numra të shënuar me njëshe, dhjetëshe dhe qindëshe.</p> <p>Harta të mëdha për vendosje të vlerave (shigjetë) deri në tri shifra.</p> <p>Harta të vogla me shigjetë për punë në tavolinë.</p> <p>Harta të mëdha për vendosje të vlerave (shigjetë) deri në tri</p>	<p>Shfrytëzoni ndihmë vizuale deri sa nxënësit të bëhen të sigurt pa të.</p> <p>Puna në çifte I mundëson nxënësve të bisedojnë për idetë e tyre.</p> <p>Puna në çifte i mundëson nxënësve të bisedojnë për idetë e tyre.</p> <p>Disa nxënësve iu nevojitet përkrahja plotësuese me atë që do të keni harta të koduara në ngjyrë për punë në tavolinë.</p> <p>Shfrytëzojeni funksionin ekzistues në llogaritës. Shfrytëzoni katrorë deri 100 për shënim të rezultatit të shumëzimit me 10.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente																		
<p>Shumë numra dyshifrorë me 10 dhe e kupton rezultatin.</p> <p>Rrumbullakon numra dyshifrore deri te dhjetëshja e përafërt dhe numra treshifrorë deri te qindëshja më përafërt.</p> <p>Krahason numra treshifrorë duke i shfrytëzuar shenjat „&gt;“ dhe „&lt;“ dhe gjen numër ndërmjet tyre.</p> <p>Radhit numra dyshifrorë dhe</p>	<p>shohin nxënësit? Shfrytëzoni tabelë që të numëroni para dhe pas në njësi, dhjetëshe, qindëshe, ....</p> <p>Dëftojeni lidhjen ndërmjet numrave në çdo kolonë si lëvizni teposhtë (x me 10).</p> <p>Rrumbullakoni numra më të vogël se 100 deri në më të afërmen 10 (dhjetëshe):</p> <p>43 është 40 rrumbullakoni në më të afërmen 10; 58 është 60 rrumbullakosni në më të afërmen 10; 25 është 30 rrumbullakosni në më të afërmen 10.</p> <p>Jepni shembuj nxënësve. Çka vërejnë për shifrën e fundit dhe në dhjetëshen në të cilën është rrumbullakuar numri?</p> <p>Rrumbullakojnë cilindo numër treshifrorë në qindëshen më të afërt: 422 është më afër deri 400 se sa deri 500. Jepni më shumë shembuj. Pyetni nxënësit çka vërejnë?</p> <p>Veni numra treshifrorë në varg numerik të zbrazët. Shfrytëzim i shenjave „&gt;“ dhe „&lt;“. Ilustroni me shembuj: Të gjendet numër ndërmjet numrave treshifrorë që më herët janë vendosur në varg të zbrazët numerik. Diskutoni.</p> <p>Shfrytëzoni radhitje të numrave dyshifrorë dhe treshifrorë në situatë praktike. Pyetje: Cili numër është më i vogël? Cili numër është më i madh? Veni numra në vargun e zbrazët të numrave.</p>	<p>shifra.</p> <p>Harta të vogla me shigjetë për punë në tavolinë.</p> <p>.</p> <p>Llogaritës.</p> <p>Tabela për vënie të vlerës</p> <table border="1" data-bbox="1113 438 1428 544"> <tr> <td>1</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>4</td> <td>5</td> <td>...</td> </tr> <tr> <td>10</td> <td>20</td> <td>30</td> <td>40</td> <td>50</td> <td>...</td> </tr> <tr> <td>100</td> <td>200</td> <td>300</td> <td>400</td> <td>500</td> <td></td> </tr> </table> <p>Letra me shifra të mëdha që të përdoren në orë mjaftueshëm që të bëhen numrat me 2 dhe 3 shifra.</p> <p>varg i zbrazët të numrave për sqarim të tërë paraleles.</p> <p>Varg i zbrazët të numrave (i vogël) për punë në bankë.</p> <p>Letra me shifra të mëdha dhe të vogla.</p>	1	2	3	4	5	...	10	20	30	40	50	...	100	200	300	400	500		
1	2	3	4	5	...																
10	20	30	40	50	...																
100	200	300	400	500																	



Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>treshifrorë.</p> <p>Bën vlerësim të arsyeshëm të një numri ndërmjet dhjetësheve (për shembull: prej 30 deri 50).</p> <p><b>Operacionet matematikore:</b> <i>Strategjitë e të menduarit</i></p> <p>I din faktet vijuese për mbledhje dhe zbritje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbledh dhe zbret qindëshe deri 1000 (<math>400+600=1000</math>);</li> <li>- Mbledh dhe zbret numra dyshifrorë të cilët janë të pjesëtueshëm me 5 deri 100 (<math>100-15=85</math>).</li> </ul> <p>Fillon ta mësojë tabelën shumëzimit me 4.</p> <p>E din tabelën e shumëzimit me 2, 3, 5 dhe 10.</p> <p>Shpejt I ndan numrat prej 1 deri 20 dhe vlerat e fituara I ndan në gjysmë.</p>	<p>Kërkoni nxënësi të sqarojë si e ka bërë vlerësimin, si dhe sqarim pse e njëjta është e arsyeshme Bisedoni për strategji të ndryshme për bërje të vlerësimit.</p> <p>Përsëritni në nivel të paraleles me pyetje të kahëzuara.</p> <p>Përsëritni në nivel të paraleles me pyetje të kahëzuara.</p> <p>Përsëritni të tabelës me 2, 3, 5 dhe 10 me tërë paralelen.</p> <p>Planifikoni aktivitete praktike që të dyfishojnë numra prej 1 deri 10 dhe vlerat e fituara ti ndajnë në gjysmë, pastaj edhe për numrat deri 20.</p> <p>Në nivel të tërë paraleles përsëritni për dyfishimin e numrave prej 1 deri 20 dhe vlerat e fituara ti ndajnë në gjysmë.</p>	<p>Letra me shifra të mëdha dhe të vogla. Varg I zbrazët për numra të mëdhenj dhe të vogël.</p> <p>Për vlerësim shfrytëzoni gjësende të vogla, fjalë nga faqja e librit, fije bari në metër katrorë.</p> <p>Pajisje për llogaritje. Llogaritës. Vendosja e tabelës së madhe me vlera. Tabela „qindëshe“.</p> <p>Tabela për shumëzim me 4. Llogaritës .</p> <p>Tabela për shumëzim me 2, 3,5 dhe 10. Llogaritës.</p> <p>Pajisje për llogaritje. Llogaritës me shfrytëzim të funksionit konstant.</p>	<p>Të shënohen numrat e pjesëtueshëm me 5 në tabelën „qindshe “ ashtu që nxënësit të mund të vërejnë vargun.</p> <p>Përsëritja me tërë klasën do tu mundësojë nxënësve të përforcojnë atë që e dinë dhe ta mësojnë atë që nuk e dinë. Disa nxënës do të kenë nevojë nga përkrahja e tabelave për shumëzim dhe pjesëtim më gjatë kohë se tjerët.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Shpejt I dyfishon numrat e fituar me shumëzim me 5 (&lt; 100) dhe numrat e fituar i ndan në gjysmë.</p> <p><b>Mbledhje dhe zbritje</b></p> <p>Mbledh dhe zbret çifte numrash dyshifrorë.</p> <p>Mbledh numra treshifrorë dhe dyshifrorë me shënim.</p> <p>Mbledh / zbret numra njëshifrorë me /nga numra treshifrorë.</p> <p>Gjen për 20, 30,...90, 100, 200, 300 më të madh/më të vogël nga numri</p>	<p>Pastaj shfrytëzoni fakte të njohura që të gjendet numri I dyfishuar I numrave të fituar me shumëzim me 5 (për shembull. E dyfishon numrin 15 ose e dyfishon numrin 45). Shfrytëzoni numrat e dyfishuar për nxënësit që të gjejnë gjysmën e tyre.</p> <p>Diskutoni për strategjitë e mbledhjes dhe zbritjes e numrave 2 shifrorë. Nxënësit këmbëjnë idetë dhe e sqarojnë metodën e tyre.</p> <p>Përdorni fletore si ndihmë për llogaritje. Shënojeni mbledhjen logjike në shprehje matematikore duke përdorë shenjat „+ “ dhe „ = “.</p> <p>Diskutoni për strategjitë që janë përdorë: Numërim para , numërim prapa (zbritje).</p> <p>Shfrytëzimi i tabelës për futjen e vlerave për ta parë vargun e numrave, si dhe për gjetjen më shumë ose më pak nga ndonjë numër. Shfrytëzoni karta (letra) për futjen e vlerave deri në 4 shifra.</p>	<p>Tabela „qindëshe “.</p> <p>Varg i zbrazët për numra.</p> <p>Tabela me vlera</p>	<p>Mundësoni nxënësve të flasin për strategjitë e tyre për zgjidhje që të shohin se ka me shumë mënyra për zgjedhjen e problemit, dhe jo vetëm një.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>treshifrorë i dhënë.</p> <p><b>Shumëzimi dhe pjesëtimi</b></p> <p>E kupton raportin ndërmjet përgjysmimit dhe dyfishimit.</p> <p>Shumëzon numra njëshifrorë dhe pjesëton numra dyshifrorë me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe 10.</p> <p>Kupton se në pjesëtim mund të ketë mbetje (në fillim si „tepricë” ).</p>	<p>Nisuni nga e njohura; shfrytëzoni dyfishim që të gjeni numrin e panjohur. Gjeni vlerat nga tabelat me 4 me dyfishim të vlerave nga tabela me 2. Me pjesëtim të vlerave në gjysmë nga tabela me 4 e fitoni tabelën me 2. Kërkoni nxënësit ti dyfishojnë vlerat nga tabela me 5 që ta fitojnë tabelën me 10.</p> <p>Për fillim shfrytëzoni tabelë për shumëzim dhe /ose tabela tjera, përsëritje me tërë paralelen me pyetje të kahëzuara me qëllim nxënësit të kuptojnë se pjesëtimi është operacion i kundërt i shumëzimit. Shfrytëzoheni këtë që nxënësit të bëjnë lidhje të fakteve, nëse për shembull: 16 e pjesëtuar me 2 =8, 8 · 2 =16; 30 e pjesëtuar me 10 = 3, 3 · 10 = 30.</p> <p>Numëroni 10 gjësende. Pjesëtoni në 2 grupe të barabarta. Largoni disa gjësende, shembull 3,e tjerat 7 ndani në dy grupe. Pyetni nxënësit: çka ndodhë? Ka mbetje? Përsëritni aktivitetin disa here, duke i përfshi të gjithë numrat prej1-10. Shënoni ata numra të cilët pjesëtohen pa mbetje dhe ata të cilët pjesëtohen me mbetje . Provoni me numra të mëdhenj. Shënoni numrat që kanë5 mbetje dhe ata që nuk kanë. Shfrytëzoni tabelë „qindëshe “ për shënim. Parashtroni</p>	<p>Letra me vlerë.</p> <p>Tabela „qindshe “.</p> <p>Tabela për shumëzim</p> <p>Pajisje për llogaritje. Katrorë deri 100 për shënim.</p>	<p>Tabelat mund tu jenë përkrahje vizuale për nxënësit.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>E kupton raportin ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit dhe shënon shembuj.</p>	<p>pyetje me qëllim të nxënësit të nxitni të menduar dhe sjellje të përfundimit si për shembull. Çka vëreni?  A mund të parashikoni cilat numra do të kenë mbetje, e cilat jo? Si e dini? Çka nëse numri i pare I zgjedhur nuk mund të pjesëtohet në dy pjesë?  Përpiquni me numra të mëdhenj.  Shënoni numrat që kanë mbetje dhe ata që nuk kanë. Shfrytëzoni katrorë deri 100 për shënim. Çka vëreni?  A mund të parashikoni cilat numra do të kenë mbetje e cilët jo? Si e dini?  Çka nëse numri fillestar nuk është shumëzues me 2?</p> <p>Kuptoni se pjesëtimi është e kundërt me shumëzimin (pjesëtimi është inverse me shumëzimin). Shfrytëzoni këtë që të gjeni fakte të lidhura: 16 e pjesëtuar me 2 =8, <math>8 \cdot 2 =16</math>.  Provoni me kombinime tjera të numrave.</p>	<p>Katrorë për shumëzim.  Tabela.</p>	
<p><b>Zgjidhje e problemeve</b></p>			

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Shfrytëzim I teknikave dhe aftësive në zgjidhje të problemeve matematikore.</p> <p>Zgjedh dhe zbaton strategji përkatëse të të menduarit për njësim.</p> <p>I zgjedh dhe zgjidh detyra të thjeshta tekstuale (me njëri nga katër operacionet) dhe operacione në dy etapa (mbledhje dhe zbritje) dhe fillon ti tregojë, për shembull: me vizatime ose me shënim të shprehjeve.</p> <p>I provon rezultatet nga mbledhja e dy numrave duke shfrytëzuar zbritjen edhe të mbledhjes të disa numrave me ndërrim të vendeve të</p>	<p>Për mbledhje: Kërkoni çifte numrash shuma e të cilëve është 10 ose 20 dhe në fillim punoni me ta; Filloni me numrin më të madh Kërkoni çifte shuma e të cilëve është 9, 11, 19, 21 .... Dhe shtoni këto në shumën e përgjithshme me shtim 10 dhe adaptim me 1. Ndarja në dhjetëshe dhe njëshe. Kërkoni vlera të dyfishta dhe vlera të dyfishta të përafërta. Për zbritje: Me mend mbliidni ose zbritni 9 ose 11, 19 ose 21 ... me/nga cilido numër treshifrorë (<math>264 - 9 = 255</math> sepse është njësoj si <math>265 - 10 + 1</math>) Formoni dhe njihni vargje: <math>13 + 1 = 14</math> <math>13 + 11 = 24</math> <math>13 + 21 = 34</math> .....</p> <p>Me gojë sqaroni mënyrë për zgjidhjen e problemeve dhe mendoni dhe, ku është gjegjëse, shënoni me numra, vizatoni grafik, dizajnoni hartë .....që të tregoni si është zgjidhur problem</p> <p>Kuptim dhe shfrytëzim i operacioneve inverse. Grumbullim i numrave për zbatimin e strategjive të ndryshme.</p>		

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>mbledhësve.</p> <p>E provon zbritjen me mbledhje.</p> <p>Tregon a është përgjigja e arsyeshme.</p> <p>Zgjidh problem tekstuale në një etapë (të gjitha katër operacionet) Dhe dy hapa (mbledhje dhe zbritje) dhe fillon me paraqitjen e tyre, për shembull me varg numerik.</p> <p>E shfrytëzon vetinë komutative të shumëzimit që të provojë rezultatin e shumëzimit, për shembull: provon se <math>6 \cdot 4 = 24</math> me shumëzim <math>4 \cdot 6</math>.</p> <p>E provon pjesëtimin me ndihmën shumëzimit, për shembull: <math>12 : 4 = 3</math> sepse <math>3 \cdot 4 = 12</math>.</p> <p>Vlerëson dhe e përcakton vlerën e përafërt dhe e provon rezultatin.</p>	<p>Shfrytëzoni njohurinë e nxënësve për operacionet inverse dhe shfrytëzimin e strategjive të ndryshme të të menduarit.</p> <p>Nxitni të menduar nga parashtrimi i pyetjeve: A jeni të sigurt? Si e dini? A keni mënyrë tjetër për zgjidhje?</p> <p>Shfrytëzoni mbledhje dhe zbritje, shumëzim dhe pjesëtim që të zgjidhni problem nga jeta reale të lidhur me cilëndo nga qëllimet.</p> <p>Shfrytëzoni cilëndo nga resurset e propozuara prej më parë. Kërkoni nxënësit të japin mënyrën e vet për zgjidhje, të diskutojnë dhe të japin sqarimet e tyre.</p> <p>Shfrytëzoni njohuri dhe kuptim të operacioneve inverse.</p> <p>Shfrytëzoni njohuri dhe kuptim të operacioneve inverse.</p> <p>Sqaroni si është bërë vlerësimi dhe pse është e arsyeshme.</p>		

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Bën vlerësim të arsyeshëm të përgjigjes, për shembull: me rumbullakim.</p> <p><b>Shfrytëzon kuptim dhe strategji për zgjidhjen e problemeve.</b> Paramendon tregim për detyrë të parashtruar.</p> <p>E sqaron zgjidhjen e strategjisë për zgjidhjen e problemit dhe tregon si ka arritur te rezultati.</p> <p>Analizon dhe zgjidh problem situatash dhe detyra, për shembull: problem logjike.</p>	<p>Të planifikohen aktivitete në të cilat do të rumbullakohen numra më të vegjël se 100 deri te dhjetëshja më e afërt.</p> <p>Të rumbullakohen matjet deri te dhjetëshja më e afërt dhe të fillohet me rumbullakimin e tyre deri te qindëshja më e afërt për shembull.: Rrugëtimi zgjati 58 minuta, a 60 minuta është deri te dhjetëshja më e afërt. Largesa prej shkolle deri te shtëpia ime është 123 metra, që është 100 metra deri te qindëshja me e afërt.</p> <p>Çka mund të jetë tregimi për shprehjen numerike : <math>15 + 29 - 2 = 42</math> Vet nxënësit të mendojnë tregime tjera.</p> <p>Shfrytëzoni njohuri dhe kuptim te strategjive të ndryshme, punoni në problem dhe sqaroni zgjedhjen e strategjisë së përdorur, dhe sqaroni si është fituar përgjigja. Strategjia mund të jetë e tillë çfarë askush paraprakisht nuk e ka përdorur.</p> <p>Shfrytëzoni më shumë problem me fjalë, problem logjike, gjetje të gjitha mundësive, problem me diagram dhe problem vizuale, gjetje rregulla dhe</p>		

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Përshkruan dhe vazhdon vargje me numërim para dhe pas në hapa me 2, me 3, me 4, me 5, me 10 dhe me 100.</p> <p>Njih raporte te thjeshta ndërmjet numrave, (shembull: secili numër është për tre më i madh nga ndonjë numër që është para tij, duke filluar nga numri 4).</p> <p>Analizon gjykim të thjeshtë me gjetje të shembujve që e vërtetojnë ose nuk e vërtetojnë të njëjtin (shembull kur numrit treshifrorë i shtohet 10 shifra e pare nuk ndryshon).</p> <p>Me gojë e sqaron mënyrën e zgjidhjes dhe të menduarit, duke i përfshi edhe të menduarat fillestare për përgjigjet e mundshme të problemit.</p>	<p>përshkrim modelesh (vargje).</p> <p>Zbatim me numra të plotë ose thyesa.</p> <p>Shfrytëzoni numrat 2, 4, 5 dhe shenjat, + „, „ - “ „ „ · “dhe „ = “.Sa përgjigje të ndryshme mund ti fitoni? Ndajeni këtë me tjerët në grup /paralele. Si e dini se i keni gjet të gjitha përgjigjet? Inkurajoni të zbatojnë të menduar sistematik.</p> <p>Kur shumëzoni me 3, shifrat në përgjigje çdoherë rriten për 3.</p> <p>Kur mblidhni 20 me numër treshifrorë ndërrohet shifra e dhjetësheve, e shifra e qindësheve ndërrohet /nuk ndërrohet. (shembull: <math>345+20=365</math>; <math>493+20=513</math>).</p> <p>Inkurajoni nxënësit ta sqarojnë mënyrën e zgjidhjes në nivel të klasës së tërë, gjatë punës në grup ose punë në çifte.</p>		



## 2B: Matje dhe zgjidhje e problemeve

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe material)	Komente
<p><b>Masa</b></p> <p>Din të përdorë monedha dhe bankënota.</p> <p>Përdorë fakte për mbledhje dhe zbritje deri 100 që ta llogarisë kusurin.</p> <p>Zgjedh dhe përdorë njësi përkatëse dhe instrumente për vlerësim, matje dhe shënim të rezultateve nga matjet.</p> <p>E din raportin ndërmjet kilometrave</p>	<p>Duke shfrytëzuar cilën do prej 4 operacioneve për zgjidhje të problemeve me 'tregimin' i cili përfshin të holla (tregtim, shkuarje në bankë.....) e marrë nga përditshmëria, duke diskutuar kur duhet të shfrytëzohet të holla.</p> <p>Vënia e situatave nga 'jeta reale' në klasë.</p> <p>Zëvendësoni bankënotë për vlerën e saj ekuivalente në bankënota më të vogla ose monedha.</p> <p>Me zbatim të lojës me role, me gojë tregoni metodat dhe të menduarat dhe, nëse është adekuate, shënoni shprehje numerike që të tregoni si është zgjidh problemi.</p> <p>Zgjidhni dhe shfrytëzoni pajisje të ndryshme për matje: vizore, peshore, lenta, bokall, menzura ...</p> <p>Shfrytëzoni vijë për matje dhe vizatoni vijë deri te gjysma më e afërt e „cm“.</p> <p>Lexoni shkallë deri te ndarja e shënuar më e përafërt në vizor, peshore ose bokall. Shënoni përqindjet dhe matjet me zbatim të njësisve të ndryshme.</p> <p>Nxënësit duhet të dinë se 1 kilometër = 1000 metra 1 metër = 100 centimetra</p>	<p>Mbishkrim ose letra e cila tregon notacion.</p> <p>Pjesë të vogla për lojë me role në klasë.</p> <p>Të holla të vërteta.</p> <p>Të holla të vërteta.</p> <p>Probleme të cilat nxënësit do ti zgjidhin.</p> <p>Pajisje e ndryshme për matje.</p> <p>Letra të ngjitura.</p>	<p>Çdoherë kur është e mundur, më së miri është nëse nxënësit mund të ballafaqohen me situatë nga jeta reale, me përdorim të të hollave të vërteta.</p> <p>Fusha e lojës me role mund të jetë shumë e vogël (në tavolinë) dhe nuk do të merr shumë vendosje.</p> <p>Shfrytëzoni komplete</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe material)	Komente
<p>dhe metrave, metra dhe centimetra, kilogram dhe gram, litra dhe mililitra (shembull: 1 km = 1000 m).</p> <p>E lexon ndarjen me te përafërt, duke shfrytëzuar instrumente për matje të numëruar ose pjesërisht të numëruar.</p> <p>Shfrytëzon vizore për të vizatuar dhe mate vijë deri në centimetrin më të përafërt.</p> <p>Zgjidh problem tekstuale në të cilët përfshihen matje.</p>	<p>1 kilogram = 1000 gram 1 litër = 1000 mililitra Parashtroni pyetje ku përgjigja mund të jepet me përdorim të njësive për masë relative gjegjëse.</p> <p>Mundësoni nxënësit ta lexojnë shkallen deri te ndarja me e përafërt. Kjo mund të bëhet praktikisht ose me letra me foto dhe lektyra për lexim. Pasi nxënësit të fitojnë siguri, jepni vetëm letra me foto dhe kërkoni me fjalë të tyre të lexojnë. Lidhja me situatë nga jeta reale: Shembull: matet gjatësia e një libri, lartësia e një tavoline. Bëni 2D vizatime ose 3D modele ku gjatësia e secilës brinjë matet me centimetra dhe gjysmë centimetra.</p> <p>Paramendoni tregime të cilët përfshijnë të holla, gjatësi, masë ose vëllim. Fëmijët i zgjidhin problemet dhe paramendojnë detyra të veta tekstuale që i ndajnë bashkë me pjesëmarrësit.</p> <p>Të dihet se 1 vit = 365 ditë ose 52 javë</p>	<p>Letra me foto.</p> <p>Letra për lexim.</p> <p>Vizore.</p> <p>Lenta për matje.</p>	<p>prej letrave të ngjitura ku përgjigja e pyetjes paraprake qon deri te pyetja e radhës: Unë kam 500 metra/ kush ka gjysmë kilometër? Duhet pas numër të mjaftueshëm letra për çdo nxënës në paralele ose 1 deri 2 nëse punohet në çifte.</p> <p>Kjo mund të bëhet si aktivitet I të gjithë paraleles e cila pastaj mund të vazhdojë si punë me çifte ose grupe, duke nxitur diskutim.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe material)	Komente
<p>Propozon dhe shfrytëzon njësi përkatëse për matje të kohës dhe e din raportin ndërmjet tyre (sekondë, minutë, orë, ditë, javë, muaj, vit).</p> <p>E lexon kohën e orëve analoge dhe digjitale deri me se afërmi 5 minuta në orë analoge dhe minuta më e afërt në orë digjital.</p> <p>Fillon të njehsojë interval të thjeshta kohore në orë dhe minuta.</p>	<p>ose 12 muaj 1 javë = 7 ditë 1 ditë = 24 orë 1 orë = 60 minuta 1 minutë = 60 sekonda</p> <p>Të shfrytëzohet kalendar. Saktë ta shënojnë datën. Të dinë dhe të munden ta shënojnë datën e vet të lindjes.</p> <p>Parashtroni pyetje: Si do ta matni kohën e nevojshme për një udhëtim? Çka do të shfrytëzoni që të matni nga një ditëlindje deri te tjetri?</p> <p>Me zbatim të orëve analoge dhe digjitale të gjinden mënyra të ndryshme ta tregoni kohën e njëjtë si: 7.45 ose 45 minuta pas 7 ose 15 minuta në 8. Lidhni me kohën digjitale.</p> <p>Propozoni njësi kohore përkatëse që ta matni kohën (si për shembull: ta hani shujtën e juaj, te përgatiteni për të fjetë në krevat, te udhëtoni deri në shkollë .....). Merrni ide nga nxënësit.</p> <p>Lidhni me njësitë për matje të kohës.</p>	<p>Letra ngjithëse.</p> <p>Kalendarë. Ditarë. Renditje të ngjarjeve.</p>	<p>Shfrytëzoni pyetje shumë të hapura. Matja e një udhëtimi mund të zbatohet. Udhëtimi në dhomë mund të jetë e matur në minuta, por udhëtimi në shtet tjetër do të matej në orë.</p> <p>Shfrytëzoni letra të ngjitura për kohë, edhe analoge edhe digjitale .</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe material)	Komente
Lexon kalendar dhe njehson interval kohore në javë ose ditë.			
<p><b>Zgjidhje e problemeve</b></p> <p>Zgjedh dhe zbaton strategji përkatëse të të menduarit për njehsim.</p> <p>Fillon ti kuptojë njësit matëse për gjatësi\, peshë, vëllim dhe kohë dhe i shfrytëzon të bëjë matje përkatëse.</p> <p>Vlerëson dhe e përcakton vlerën e përafërt dhe e provon rezultatin.</p> <p>Bën vlerësim të arsyeshëm të përgjigjes, shembull: me rumbullakim.</p> <p>Përcakton a është përgjigja e arsyeshme.</p> <p>Paramendon tregim për detyrë të</p>	<p>Shfrytëzoni strategji të të menduarit të zgjidhni problem me matjet në numër të madh kontestesh.</p> <p>Me gojë sqaroni metodat dhe të menduarit edhe ku është shprehja numerike adekuate që të tregoni si është zgjidhë problemi.</p> <p>Shfrytëzoni aktivitet praktik që ta rritni njohurinë, aftësitë dhe kuptimin.</p> <p>Vlerësoni e pastaj provoni: moshën e fëmijës më të rritur në shkollën tuaj. Shfrytëzoni vite, muaj (dhe ditë ); sa gjatë flini natën; Sa kohë është e nevojshme të arrini në shkollë. Kërkoni nga nxënësit të japin ide tjera.</p> <p>Zbatimi me të holla si dhe me masa tjera.</p> <p>Pyetni ‘Si e fitove atë? Çka të ndihmoi? Çka ishte e vështire? A do ta ndërrosh vlerësimin tënd? Pse?</p> <p>Luajtje e roleve, shembull „tregu“ Isha në treg, por kisha të holla të mjaftueshme vetëm për 2 gjera. Bleva mollë dhe dardha. Sa para kam pasur?</p>	<p>Resurse praktike për matjen.</p>	<p>Puna praktike ndihmon në kuptim.</p> <p>Kërkesa nga nxënësit të japin ide individuale mund ta rritë të kuptuarit e tyre të detyrës.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe material)	Komente
<p>parashtruar, duke i përfshi në atë kontest edhe të hollat.</p> <p>E sqaron zgjedhjen e strategjisë për zgjidhjen e problemit dhe tregon se si ka arritur deri te rezultati.</p>	<p>Bëni tregimet më të komplikuar sipas mundësisë.</p> <p>Luani role. Kur tregu, mund të shënoni çka keni blerë dhe sa u ka kushtuar ajo. Mund të përdorni lista dhe tabela për njehsim më preciz.</p>		

## 2C: Punë me të dhëna dhe zgjidhje e problemeve

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p><b>Organizimi, kategorizim dhe paraqitje e të dhënave</b></p> <p>Përgjigjet në pyetje nga përditshmëria me mbledhje, organizim dhe interpretim I të dhënave.</p> <p>Përdorë tabela për shpeshtësi, piktograme (simbole të cilat paraqesin një ose dy njësi) dhe diagram shtyllorë.</p> <p>Përdor diagram të Venit ose Kerolovit që të grumbulloj të dhëna dhe objekte sipas dy kriterëve.</p>	<p>Përdorni aktivitetet për lexim të të dhënash dhe rregullim të të dhënash të fituara si për shembull. Nga hulumtimi I kafshëve në mese të ndryshme.</p> <p>Mund të bëni lidhje me cilëndo temë e cila është vijuese në shkollë ose bashkësi ose në botë më gjerë, si për shembull.: Dita e sportit, Lojërat olimpike... Mendoj se personi me këmbë me te gjata mund të kërcejë më gjatë. Çka mendoni? Si mund të marrim vesh? Si do ti shkruani mendimet ose të dhënat e juaja?</p> <p>Parashtroni pyetje të cilat do të nxitin të menduar siç janë:          Si duhet ti paraqesim ato të dhëna?          Si do ta dimë atë që duhet ta dimë?          Cilat informata do ti mbledhim?          Si do ti mbledhim?          Cila mënyrë do të jetë më e mira të na tregojë atë që duhet ta dimë? Pse do ta shfrytëzonim këtë mënyrë?</p> <p>Kërkoni nxënësit të klasifikojnë lëndë, forma ose numra sipas një kriteri, pastaj sipas përparimit të tyre sipas dy</p>	<p>Shirita matës, vizore, shkopinj me numra për matje, rrotull me numra.</p> <p>Resurset tjera do të varen nga problem I parashtruar.</p> <p>Pyetje të ndryshme të cilat do ti shfrytëzojnë të gjitha mënyrat e ndryshme të paraqitjes.</p>	<p>Këto janë aktivitet ideale për punë në grupe dhe vënia e rregullave. Secili grup do të ketë mënyrën e vet të mbledhjes së të dhënave dhe mënyrën e vet të shënimit, që do të qojë deri te diskutimi I madh gjatë informacionit kthyes.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
	<p>kritereve, dhe le të përdorin diagram të Venit ose Kerolovit për të treguar rezultatet.</p> <p>Shembull: Fëmijë që udhëtojnë deri në shkollë /me automjet.</p> <p>Përgjigjen ne pyetje siç janë: Cila është ushqimi jonë I preferuar, ngjyra, sporti, ylli filmik ...</p>		
<p><b>Zbatimi i të kuptuarit dhe strategjive në zgjidhjen e problemeve</b></p> <p>Përdor lista dhe tabela për zgjidhje sistematike të problemeve.</p>	<p>Shpejt mblidhni të dhënat duke treguar me dorë ose me vota dhe bëni tabelë të thjeshtë të shpeshtësisë.</p> <p>Diskutoni për përfundimet: Cili është më së shumti /më së paku I popullarizuar? Cili ka pas më shumë se 12 vota? Cili ka pas ma pak se 7 vota? Çka nëse pyesim paralele tjetër? A mendoni se rezultatet do të ishin të njëjtë ose të ndryshëm? Pse?</p>		

### 3A: Numri dhe zgjidhje e problemeve

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente																		
<p><b>Numra dhe sistem i numrave</b></p> <p>E kupton rezultatin nga shumëzimi i numrave dyshifrorë me 10.</p> <p>Rrumbullakon numra dyshifrorë deri te dhjetëshja më e afërt dhe numra treshifrorë deri te qindëshja më e afërt.</p> <p>Krahason numra treshifrorë duke i shfrytëzuar shenjat „&gt;“ dhe „&lt;“ dhe gjen numër ndërmjet tyre.</p>	<p>Tregoni tabelë të madhe të vlerave të vendosura. Kerlovi, vërejeni dhe tregoni. Çka vërejnë nxënësit? Përdoreni tabelën që të numëroni para dhe pas në njëshe, dhjetëshe, qindëshe ... Përcaktojeni lidhjen ndërmjet numrave në çdo kolonë si lëvizni poshtë (x 10).</p> <p>Rrumbullakimi i numrave më të vegjël se 100 deri te 10 më e afërt (dhjetëshja): 43 është 40 e rrumbullakuar në dhjetëshen më të afërt; 58 është 60 e rrumbullakuar në dhjetëshen më të afërt; 25 është 30 e rrumbullakuar në dhjetëshen më të afërt Pyetni nxënësit çka vërejnë për shifrën e fundit dhe dhjetëshen në të cilën është rrumbullakuar numri? Rrumbullakoni cilindo numër 3 shifrorë deri te 100 më e afërt: 422 është më afër 400 se sa 500. Jepni shembull. Çka vëreni?</p> <p>Vendosja e numrave treshifrorë në varg të zbrazët të numrave. Vendosja e shenjave „&gt;“ dhe „&lt;“. Ilustrim me shembuj. Gjeni numër ndërmjet. Përcaktoni në vargun e numrave. Diskutoni.</p>	<p>Llogaritës</p> <p>Tabela me fushë dhe vlerë</p> <table border="1" data-bbox="1115 446 1430 537"> <tr> <td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td><td>...</td> </tr> <tr> <td>10</td><td>20</td><td>30</td><td>40</td><td>50</td><td>...</td> </tr> <tr> <td>100</td><td>200</td><td>300</td><td>400</td><td>500</td><td></td> </tr> </table> <p>Harta të mëdha të mjaftueshme të fitohen numra dyshifrorë dhe treshifrorë</p> <p>Varg i zbrazët i madh për vendosje të numrave. Varg i zbrazët i vogël për numra për në bankë. Letra të vogla dhe të mëdha me shifra.</p>	1	2	3	4	5	...	10	20	30	40	50	...	100	200	300	400	500		<p>Përdorni funksionin konstant në llogaritës. Përdorni katrorë deri 100 që ti shënoni rezultatet e shumëzimit me 10.</p>
1	2	3	4	5	...																
10	20	30	40	50	...																
100	200	300	400	500																	



Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Radhit numra dyshifrorë dhe treshifrorë.</p> <p>Bën vlerësim të arsyeshëm të një numri ndërmjet dhjetësheve (shembull: prej 30 deri 50).</p> <p>Gjen gjysmën e numrave tek dhe çift deri 40 dhe l shënon si për shembull: <math>13 \frac{1}{2}</math>.</p> <p>Kupton se thyesat janë pjesë e një tërësie dhe l shënon, si për shembull: <math>\frac{3}{4}</math> është tre të katërtat, <math>\frac{2}{3}</math> është dy të tretat.</p>	<p>Të kuptohen dhe shfrytëzohen në shembuj praktik numrat dyshifrorë dhe treshifrorë. Pyetje: Cili numër është më i vogël? Cili numër është më i madh? Vendosni numra në vargun e zbrazët të numrave.</p> <p>Sqaroni si ka qenë e bërë vlerësimi dhe arsyetoni atë. Pse mendoni s e është e arsyeshme? Flisni për strategji të ndryshme për fitim të vlerësimeve.</p> <p>Përgjysmoni numrat çift. Çka ndodhë nëse duam të përgjysmojmë numër tek saktë pa mbetje? Shfrytëzoni material praktike shembull. Prerje e mollës në gjysmë. Veni <math>\frac{1}{2}</math>. Sqaroni nxënësve çka paraqesin numëruesi dhe emëruesi, pa l emëruar kuptimet.</p> <p>Të kuptohet se <math>\frac{3}{4}</math> është tre të katërtat dhe se paraqet 3 pjesë të barabarta nga një tërësi e ndarë në 4 pjesë të barabarta.</p> <p>Jepni mundësi të gjendet <math>\frac{3}{4}</math> në numër të madh kontestesh.</p>	<p>Letra të mëdha dhe të vogla me shifra. Varg i zbrazët i madh dhe i vogël për vendosje të numrave.</p> <p>Gjësende të vogla. Ngjitëse për letër në kuti. 10 gramë oriz ....</p> <p>Gjësende që mund të prehen në gjysmë.</p> <p>Letër me masë me madhësi të ndryshme.</p> <p>Katrorë për shumëzim.</p>	

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Njeh barabarësi ndërmjet thyesave <math>\frac{1}{2}, \frac{2}{4}, \frac{4}{8}, \frac{5}{10}</math> duke shfrytëzuar aktivitete praktike dhe diagrame.</p> <p>Fillon ti lidhë thyesat me ndarje në pjesë të barabarta (shembull: ndarja e picës në 4 pjesë të barabarta 4 personave ose ndarja e dy mollëve 4 personave).</p> <p>Gjen gjysma, të treta, të katërta dhe të dhjeta të formave dhe numrave natyrorë me shfrytëzim të manipuluesve (shembull. zhetonë, gurë).</p> <p><b>Njehsim: Strategji të të menduarit</b></p>	<p>Përsëritni për <math>\frac{2}{3}, \frac{1}{2}, \frac{1}{10}</math>.</p> <p>Me përdorim të katrorit për shumëzim, shqyrtoni cilat do 2 rende të cilat janë njëri afër tjetrit. Çka vëreni?  2 4 6 8 10 12 14 16 .....  4 8 12 16 20 24 28 32  Lexoni si thyesa. Çka vëreni?  A vlen kjo për cilat do 2 rende?</p> <p>Shfrytëzoni varg me numra fillimisht deri në dhjetë, pastaj deri 100. Zgjidhni cilindo numër të vargut me numra. Vlerësoni ku gjendet gjysma e atij numri.  (e pjesëtuar me 2). Çka duhet të shënojmë aty?  Shfrytëzoni fakte tjera të njohur për shumëzim dhe pjesëtim.</p> <p>Shfrytëzoni forma për thyerje që të fitohen të ashtuquajtura mure me thyesa.  Shfrytëzoni njohuri për pjesëtim që ti gjeni gjysmat, të tretat, të katërtat dhe të dhjetat nga numrat pa mbetje.</p> <p>Përsëritje me tërë paralelen me pyetje të përgatitura prej ma parë.</p>	<p>Vargu i zbrazët i numrave.  Vargu i shënuar me numra.</p> <p>Varg me numra 1-10.  Varg me numra 1 – 100.</p> <p>Forma të rregullta.  Mur me thyesa.  Tabela për pjesëtim.</p> <p>Pajisje për llogaritje.</p>	

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>I din faktet vijuese për mbledhje dhe zbritje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbledh dhe zbret qindëshe deri 1000 (<math>400+600=1000</math>);</li> <li>- Mbledh dhe zbret numra dyshifrorë të cilët janë të pjesëtueshëm me 5 deri 100 (<math>100-15=85</math>).</li> </ul> <p>E din tabelën e shumëzimit me 2, 3, 5 dhe 10.</p> <p>Fillon ta mësojë tabelën e shumëzimit me 4.</p> <p>Shpejt I ndan numrat prej 1 deri 20 dhe numrat e fituar I ndan në gjysmë.</p>	<p>Përsëritje me tërë paralelen me pyetje të përgatitura prej ma parë.</p> <p>Përsëritje me tërë paralelen me pyetje të përgatitura prej ma parë.</p> <p>Aktivitet praktike që të gjinden vlerat e dyfishta dhe gjysmat të gjithë numrave deri 10, e pastaj deri 20.</p> <p>Përsëritje me tërë paralelen të fakteve për vlera të dyfishta dhe të përgjysmuara deri 10 e pastaj deri 20.</p> <p>Shfrytëzoni fakte të njohura për të</p>	<p>Kalkulator. Tabelë me vlerë. Katrorë deri 100.</p> <p>Tabela për shumëzim. Tabela për pjesëtim.</p> <p>Tabela për shumëzim. kalkulator.</p> <p>Katrorë deri 100</p>	<p>Shënim i numrave të pjesëtueshëm me 5 në katrorë deri 100 ashtu që mund të shihet vargu. Përsëritje me tere paralelen iu mundëson të gjithë nxënësve të marrin pjesë në atë që e dinë dhe të dëgjojnë dhe mësojnë atë që nuk e dinë. Disa nxënësve u duhen tabelat për shumëzim dhe pjesëtim si përkrahje më gjatë kohë se të tjerët</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Shpejt I ndan numrat të fituar me shumëzim me 5 (&lt;100) dhe numrat e fituar i ndan në gjysmë (shembull e ndan numrin 15 ose e ndan numrin 45).</p> <p>Shpejt I ndan numrat të fituar me shumëzim me 50, prej 50 deri 500 (shembull; ndan numrin 150 ose e ndan numrin 450).</p> <p><b>Mbledhje dhe zbritje</b> Mbledh dhe zbret çifte numrash dyshifrorë.</p> <p>Mbledh dhe zbret numra dyshifrorë dhe treshifrorë me 10 dhe me dhjetëshe të plota (shembull.,570-40=530).</p> <p>Mbledh dhe zbret numra njëshifrorë me /nga numra treshifrorë.</p>	<p>treguar vlera të dyfishta të shumëzuesve me 5. Shfrytëzoni katrorë deri 100 për shënim.</p> <p>Shfrytëzoni njohuri të vlerave të dyfishta që të gjeni gjysma. Përsëritje nga e tërë paralelja me pyetje të përgatitura paraprakisht.</p> <p>Shqyrtim I strategjive për mbledhje dhe zbritje të numrave dyshifrorë. Nxënësit hapin ide dhe e sqarojnë metodën e vet.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Filloni me numër me te madh.</li> <li>• Pjesëtim dhe ri përbërje.</li> <li>• Veni numrin mete madh te parin ne renditje për njehsim.</li> <li>• Ndarje ne dhjetëshe dhe njëshe.</li> <li>• Vëre se kur dy numra janë njeri afër tjetrit, më lehte është të gjendet dallimi me numërim para dhe jo pas.</li> </ul> <p>Përdorni fletore dhe vargje te zbrazëta për numra si ndihmë në llogaritje. Shënojeni mbledhjen e menduar ne shprehje numerike dhe me përdorim te „+“, „-“dhe „=“.</p> <p>Diskutoni strategjitë: Numërim para; Numërim pas zbritje)</p> <p>Përdorni tabela për vendosje vlerë që ti shihni vargjet e numrave dhe përdorni</p>	<p>Vargu I zbrazët I numrave.</p>	<p>Mundësia e nxënësve të flasin për metodat e tyre , dhe me këtë iu ndihmohet nxënësve tjerë të shohin se ka më shumë se një mënyrë për zgjidhjen e problemit.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Gjen për 20, 30,...90, 100, 200, 300 më të mëdhenj/më të vegjël nga numri l dhënë treshifrorë.</p> <p>Gjen mbledhës të panjohur gjatë mbledhjes së numrave shuma e të cilëve është deri 100, me zgjidhje të barazimeve si (shembull : <math>78 + \square = 100</math>).</p> <p><b>Shumëzimi dhe pjesëtimi</b></p> <p>Shumëzo numra njëshifrorë dhe pjesëto numra dyshifrorë me 2, 3, 4, 5, 6, 9 и 10.</p>	<p>për gjetje te numrit me te madh /më të vogël numër nga ndonjë numër l dhënë Përdorni letra për vënie të vlerës deri 4 shifra.</p> <p>Nxënësit të kuptojnë se përdorimi i simbolit si <math>\square</math> është vendi për shënimin e numrit të panjohur. Përdorim i fakteve deri 20: <math>12 + 8 = 20</math> <math>15 + \square = 20 \dots\dots</math> <math>\square + 7 = 20 \dots\dots</math> Ndërroni pozitën e numrit të panjohur në detyrat. Përparoni deri te numrat me te lartë që të arrini deri 100.</p> <p>Së pari shfrytëzoni tabelë për shumëzim, pastaj përsëritni me tere paralelen me pyetje te përgatitura prej ma parë.</p> <p>Kuptoni se pjesëtimi është e kundërt me prej shumëzimit (pjesëtimi është inverse në shumëzim). Shfrytëzoni këtë që të gjeni fakte të lidhura: <math>32</math> e pjesëtuar me <math>2 = 16</math> <math>16 \cdot 2 = 32</math> <math>50</math> e pjesëtuar me <math>10 = 5</math> <math>5 \cdot 10 = 50</math></p> <p>Numëroni 10 gjësende. Ndani në 2 grupe të barabarta. Përsëri mblidhni. Largoni disa dhe pjesën e mbetur pjesëtojeni në dy grupe të barabarta.</p>	<p>Vargu për numra. Katrorë deri 100.</p> <p>Katrorë për shumëzim. Tabela / grafikone.</p>	

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Kupton se në pjesëtim mund të ketë mbetje (në fillim si „tepricë“).</p> <p>E kupton raportin ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit dhe shenon shembuj.</p> <p>Shumëon numra nga dhjetëshja e dytë me 3 dhe me 5.</p>	<p>Çka ndodhë? A ka mbetje? Përsëritni disa here ashtu që të përfshihen gjithë numrat 1-10.</p> <p>Shënoni ata numra të cilat pjesëtohen pa mbetje dhe ato që pjesëtohen me mbetje.</p> <p>Përpiquni me numra të mëdhenj. Shënoni numrat që kanë mbetje dhe ato që nuk kanë. Shfrytëzoni katrorë deri 100 për shënim. Çka vëreni? A mund ta parashihni cilat numra kanë mbetje, e cilat nuk kanë? Si e dini? Çka nëse numri fillestar nuk është i pjesëtueshëm me 2?</p> <p>Kuptim se pjesëtimi është i kundërt me shumëzimin (pjesëtimi është invers me shumëzimin). Shfrytëzoni këtë që të gjeni fakte të lidhura:  <math>32 \text{ pjesëtuar me } 2 = 16</math>  <math>16 \cdot 2 = 32</math>  <math>50 \text{ pjesëtuar me } 10 = 5</math>  <math>5 \cdot 10 = 50</math></p> <p>Hulumtoni kombinime tjera të numrave</p> <p>Diskutoni strategji:  Shumëzim të dhjetësheve, pastaj njësheve dhe mbledhje bashkë.  Numërim në etapa të njëjta.  Kërkim modeli (shabllon) në përgjigje si mënyrë për vlerësim (nëse shumëzojmë me 5 numri i fituar mbaron me 5 ose 0, nëse shumëzojmë me 3 numri i fituar është i pjesëtueshëm me 3, 6, ose 9).</p>	<p>Pajisje për njehsim.  Katrorë deri 100 për shënim.</p> <p>Katrorë me shumëzim.  Tabela.</p> <p>Kalkulator.  Varg me numra.</p>	

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Fillon me pjesëtim të numrave dyshifrorë me njëshifrorë, herësi i të cilëve është pak më i madh se 10 (sh., 60 : 5 ose 33:3).</p>		<p>Katrorë deri 100.</p>	
<p><b>Zgjidhje e problemeve</b> Shfrytëzim i teknikave dhe aftësive në zgjidhje të problemeve matematikore</p> <p>Zgjedh dhe zbaton strategji përkatësete menduarit për njësim.</p>	<p>Për mbledhje: Kërkoni çifte numrash shuma e të cilëve është 10 ose 20 dhe se pari punoni me ta; Filloni me numrin më të madh Kërkoni çifte shuma e të cilëve është 9, 11, 19, 21 .... Dhe shtoni këto në Shumen e përgjithshme me shtim të 10 dhe përshtatje me 1. Ndarja në dhjetëshe dhe njëshe. Kërkoni vlera të dyfishta dhe vlera të afërta të dyfishta. Për zbritje: Me mend mbledhni ose zbritni 9 ose 11, 19 ose 21 ... me/nga cilido numër treshifrorë (264 – 9 = 255 sepse është njësoj si 265 -10 +1) Formoni dhe njihni vargje:</p>		

<p>Zgjedh dhe zgjidh detyra te thjeshta tekstuale (me një të katër operacionet) dhe operacione ne dy etapa (mbledhje dhe zbritje) dh e fillon ti tregoje, shembull: me vizatime ose me shënime shprehje.</p> <p>I provon rezultatet nga mbledhja e dy numrave duke shfrytëzuar zbritjen dhe mbledhjen e disa numrave me ndërrim te vendeve te mbledhësve.</p> <p>E provon zbritjen me mbledhje</p> <p>Dëfton a është përgjigja e arsyeshme.</p> <p>Zgjidh problem tekstuale në një etapë (me katër operacionet) dhe dy etapa (mbledhje dhe zbritje) dhe fillon me paraqitjen e tyre për shembull ne varg numerik.</p>	<p> <math>13 + 1 = 14</math>  <math>13 + 11 = 24</math>  <math>13 + 21 = 34 \dots</math> </p> <p>Me gojë sqaroni mënyrën e zgjidhjes së problemeve dhe mendoni, ku është adekuate, shënoni me numra, vizatoni grafikun, dizajnoni hartë ..... që të tregoni si është zgjidhur problemi.</p> <p>Kuptim dhe përdorim i operacioneve inverse. Rigrumbullim i numrave për zbatim të strategjive të ndryshme.</p> <p>Shfrytëzoheni njohurit e nxënësve për operacione inverse dhe shfrytëzoni strategji të ndryshme të të menduarit.</p> <p>Nxitni të menduar me parashtrim të pyetjeve: A jeni të sigurt? Si e dini? A keni mënyrë tjetër për zgjidhje?</p> <p>Shfrytëzoni mbledhje dhe zbritje, shumëzim dhe pjesëtim që të zgjidhni problem nga jeta reale të lidhur me cilat do nga qëllimet. Shfrytëzoni cilat do prej resurseve të propozuar nga më parë. Kërkoni nxënësit ta paraqesin mënyrën e vet të zgjidhjes, të diskutojnë dhe të japin sqarime.</p>		
---	--	--	--



<p>E shfrytëzon vetinë komutative të shumëzimit që ta provojë rezultatin nga shumëzimi, shembull: provon se <math>6 \cdot 4 = 24</math> me shumëzim <math>4 \cdot 6</math>.</p> <p>Provon pjesëtimin me ndihmën e shumëzimit, shembull: <math>12 : 4 = 3</math> sepse <math>3 \cdot 4 = 12</math>.</p> <p>Vlerëson dhe e përcakton vlerën e përafërt dhe e provon rezultatin.</p> <p>Bën vlerësim të arsyeshëm të përgjigjes, shembull: me rumbullakim.</p>	<p>Shfrytëzoni cilat do prej resurseve të propozuar nga më parë. Gjeni mënyrën tuaj të punës. Diskutoni dhe mendoni, duke i dhënë shkaqet tuaja.</p> <p>Shfrytëzoni njohuri dhe kuptim të operacioneve inverse.</p> <p>Shfrytëzoni njohuri dhe kuptim të operacioneve inverse.</p> <p>Sqaroni se si është bërë vlerësimi dhe arsyetoni pse është e arsyeshme .</p> <p>Të rumbullakohen matjet deri te dhjetëshja me e afërt dhe të fillohet me rumbullakimin e tyre deri ne qindëshen më të afërsi për shembull: rrugëtimi zgjati 58 minuta, a 60 minuta është deri te dhjetëshja me e afërt. Largesa prej shkolle deri te shtëpia ime është 123 metra, që është 100 metra deri te qindëshja me e afërt.</p>		
---	--	--	--

<p><b>Zbatimi I të kuptuarit dhe strategjitë në zgjidhje të problemeve</b> Paramendon tregim për detyrë të parashtruar.</p> <p>E sqaron zgjedhjen strategjisë për zgjidhje të problemit dhe tregon se si ka arritur deri te rezultati.</p> <p>Analizon dhe zgjidh problem të situatave dhe detyra, shembull: problem logjike.</p> <p>Përshkruan dhe vazhdon vargje me numërim para ose pas në etapa nga 2, nga 3, nga 4, nga 5, nga 10 dhe nga 100. Njeh raporte të thjeshta ndërmjet numrave, (shembull: secili numër është për tre me i madh se ndonjë numër që është para tij, duke filluar nga numri 4).</p>	<p>Çka mund të jete tregimi për shprehjen numerike: <math>26 \cdot 3 = 78</math></p> <p>Shfrytëzoni njohuri dhe kuptim për strategjitë e ndryshme, punoni në problem dhe sqaroni zgjedhjen e strategjisë së përdorur, dhe sqaroni si është fituar përgjigja. Strategjia mund të jetë e atillë çfarë deri atëherë askush nuk e ka përdorë.</p> <p>Shfrytëzoni më tepër problem me fjalë, problem logjike, gjetja e të gjitha mundësive, problem me diagram dhe problem vizuale, gjetje e rregullave dhe përshkrim të modeleve (vargje).</p> <p>Zbatim me numra te plotë ose thyesa.</p> <p>Shfrytëzoni numrat 2, 4, 5 dhe shenjat „ + “, „ - “, „ · “ dhe „ = “. Sa përgjigje te ndryshme mund ti fitoni? Ndajeni këtë me tjerët ne grup /paralele. Si e dini që I keni gjetë të gjitha përgjigjet? Përkrahni të zbatojnë të menduar sistematik. Ku shumëzoni me 3, shifrat në përgjigje çdo herë do të rriten për 3.</p>		
--	--	--	--

<p>Analizon gjykime te thjeshta me gjetje të shembujve që e vërtetojnë ose nuk e vërtetojnë të njëjtin (sh: kur numrit treshifrorë i shtohet 10 shifra e pare nuk ndërrohet).</p> <p>Me gojë e sqaron mënyrën e zgjidhjes dhe të menduarit, duke l përfshi edhe te menduarat në fillim për përgjigjet e mundshme të problemit.</p>	<p>Kur mbledhni 20 me numër treshifrorë, ndërrohet shifra e dhjetësheve, shifra e qindësheve ndërrohet /nuk ndërrohet. (shembull: <math>345+20=365</math>; <math>493+20=513</math>)</p> <p>Përkrahni nxënësit të sqarojnë mënyrën e zgjidhjes ne nivel të tërë paraleles, gjatë punës në grupe ose në çifte.</p>		
--	--	--	--

### 3B: Gjeometri dhe zgjidhje e problemeve

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p><b>Forma dhe te menduar gjeometrik</b></p> <p>Njeh, përshkruan dhe vizaton 2D forma duke përfshi pesëkëndësh, gjashtëkëndësh, tetëkëndësh dhe gjysmëmerrathë.</p> <p>Dallon forma 2D sipas numrit të brinjëve, kulmeve dhe këndeve të drejta.</p> <p>Dallon, përshkruan dhe bën forma 3D duke përfshi piramida dhe prizma; hulumton se si behet kubi.</p>	<p>Shfrytëzim, lexim dhe fillim me shënim te fjalëve te lidhura me 2D dhe 3D forma.</p> <p>Njohja se katërkëndësh është cilado formë 2D me katër brinjë. Te gjejë dhe të emëroje formë e cila ka veti të përcaktuara nga na e nxënësit tjetër. Luaj lojë „Memoria“ ku fotoja e formës dhe emir i formës përputhen. Luajtje domino ku fotoja duhet të përputhet me emrin.</p> <p>Klasifikon dhe riradhitja komplet prej 2D formave. Tregimi i tyre në diagram të Venit ose Kerlovit sipas vetisë si: A ka forma ose nuk ka vijë të simetrisë? A kanë brinjët gjatësi të njëjtë njëra me tjetrën? A ka ose nuk ka kënd te drejtë?</p> <p>Shembull: Le të dihet se prizma e ka prerjen e tërthortë sipas gjatësisë së saj dhe se 2 faqet e saja të fundit janë identike. Mbledhje e shembujve të kubit dhe kuadrit, prizma dhe cilindra, sfera dhe gjysmë sfera dhe përputhja e tyre me mbishkrime me emra. Hulumtime rrjeta që të zbulohet nga cila prej rrjetave të dhëna mund të bëhet</p>	<p>Format e rrejta dhe jo te drejta 2D .</p> <p>Letra për lojën „Memoria “. Domino.</p> <p>Format e drejta dhe jo te drejta 2D.</p> <p>Shembuj të prizmave Shembuj të formave tjera 3D</p> <p>Siguroni letër në formë të katrorit ose katrorë të prerë me madhësi të njëjtë që tu mundësoni nxënësve të</p>	<p>Aktivitete praktike dhe argëtuese dhe lojëra do të mundësojnë arritshmëria e të gjitha niveleve.</p> <p>Nxënësit duhet të hulumtojnë të gjitha rrjetet e ndryshme në një katror në vend se ti jepet vetëm një.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Dallon 3D forma sipas numrit dhe llojeve të brinjëve, numrit të teheve dhe kulmeve.</p> <p>Vizaton dhe realizon 2D forma me simetri refleksive dhe vizaton reflekse të formave (vija te pasqyrave përgjatë një brinje).</p> <p>Lidh 2D forma dhe 3D format me vizatime të të njëjtave.</p> <p>Njih 2D dhe 3D forma, vija të simetrisë dhe kënde te drejta ne rrethinë.</p>	<p>kub.</p> <p>Klasifikimi komplet prej 3d formave Paraqitja e tyre në diagram të Venit ose Kerolovit sipas vetive si: A ka ose nuk ka forma vija të simetrisë? A kanë ose nuk kanë brinjët gjatësi te njëjtte njëra me tjetrën? A ka ose nuk ka një ose ma shumë kënde të drejta?</p> <p>Njih dhe vizaton forma me simetri refleksive. Gjeni shembuj nga jeta e përditshme: Thurjet, logot, shkronja të mëdha.</p> <p>Mbledhje 3D forma dhe përputhje e tyre me vizatime të të njëjtave. Veni mbishkrim në format dhe vizatimet. Diskutoni për vetit e secilës formë siç veni mbishkrime. Kërkoni nga nxënësit te ju tregojnë sa më shumë për një 3D formë. Shqyrtoni vizatime me 2D dhe 3D forma, e pas shkurt kohe rrotullojeni vizatimin. Kërkoni nga grupet e nxënësve të përkujtohen në ma shumë forma në vizatim.</p> <p>Gjeni shembuj me forma të njëjta në klasë, mesi, jashtë ose në rrethin më të gjerë, duke kërkuar pjesë specifike të formës.</p>	<p>mësojnë prej sa katrorëve do të bëjnë kub. 3D forma.</p> <p>Shembuj nga jeta reale me simetri reflektuese.</p> <p>3D forma Mbishkrim me emra 3D vizatime</p> <p>2D forma. 3D forma.</p>	<p>Kjo vënie e formave i bën nxënësit më të</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Njeh kende te drejta ne 2D forma.</p> <p><b>Pozita dhe lëvizjet</b></p> <p>Shfrytëzon terminë përkatëse që të tregojë pozitë, kahe dhe lëvizje, në kahe të lëvizjes së akrepave të orës dhe në kahe të kundërt të akrepave të orës.</p> <p>Gjen dhe përshkruan pozitën e katrorit në rrjetë të katrorëve ku rendet dhe kolonat janë shënuar.</p> <p>Shfrytëzon katrorë që të vizatojë kënd të drejtë.</p>	<p>Bëni kënd prej 90 shkallë duke thyer cope letër në gjysmë vertikalisht dhe prap në gjysmë horizontalisht. Krahasoni këndin e bere që ti provoni këndet e drejta në dhomë. Bëni listë të gjithë këndeve të drejta dhe ku do të gjinden.</p> <p>Shfrytëzoni, lexoni dhe shkruani kuptime për pozitë dhe lëvizje Letrat e shënuara ngjithni në klasë.</p> <p>Luani iks pikë, duke l treguar lojtarit tjetër ku të vejë shenjë. Disejtoni hartë të pasurisë dhe jepni instruksione për gjetjen e pasurisë. Disejtoni hartë të pasurisë dhe kini komplet letra te cilat japin shenjë në rrjetë Veni letrat me fytyrë poshtë dhe lojtaret me rend e hapin letrën e sipërme. Fitues do të jetë lojtari që do ta fitojë shenjen e rrjetit të pasurisë.</p> <p>Shfrytëzoni katrorë për gjetje dhe vizatim të këndeve të drejta. Të dihet se këndi l drejtë është e katërta e rrotullimit.</p> <p>Shfrytëzoni komplet katrorësh për vizatim kënde të drejtë dhe krahasimi i tyre me kënde tjerë që të shihet se a janë ata më shumë a ma pak kënde të drejta. Shënoni rezultatet në fletë ose tabelë.</p>	<p>Copë letër.</p> <p>Letra me kuptime.</p> <p>Rrjetat ku janë shënuar kolonat dhe rendet.</p> <p>Komplet katrorë.</p>	<p>ndërgjegjshëm për matematiken rreth tyre.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
Dallon kënd me kënd të drejtë dhe njeh se dy kënde të drejtë përcaktojnë drejtëz.	Gjeni ku ka vija të drejta dhe njihni se vija e drejtë përbëhet prej 2 këndeve të drejta. mblidhni shembuj të vijave të drejta dhe provoni me zbatim të 2 këndeve të drejta.	Komplet katrorë.	
<p><b>Zbatimi I teknikave dhe aftësive në zgjidhjen e problemeve matematikore</b> Njeh raportin ndërmjet formave 2D të ndryshme.</p> <p>I njeh dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet formave të ndryshme 3D .</p> <p><b>Zbatim i te kuptuarit dhe strategji në zgjidhjen e problemeve</b> Njeh raporte të thjeshta ndërmjet formave (shembull: disa forma të dhëna kanë numër të njëjtë të vijave të simetrisë).</p>	<p>Pas përshkrimeve të dhëna nga arsimtari nxënësit njohin përshkrime të formave të ndryshme 2D dhe diskutojnë për të menduarit e tyre.</p> <p>Kuadri ka 6 brinjë. Kubi ka 6 faqe katrorë. A është kubi kuadër? A është kuadri kub? Krahasoni dhe gjeni dallimet e formave tjera 3D. Bëni listë ose tabelë që ti tregoni vetitë e çdo forme</p> <p>Nxitni diskutim në çifte ose grupe të vogla. Kërkoni informate kthyesë nga e terë paralelja.</p>	<p>Pajisja praktike e cila tregon formë 2D.</p> <p>Pajisja praktike e cila tregon formë 3D.</p> <p>2D dhe 3D forma.</p>	<p>Sfidojeni te menduarit e nxënësit Lidhni këtë aktivitet me diagram të Venit ose Kerolovit.</p>

### 3C: Matje dhe zgjidhje e problemeve

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p><b>Masa.</b> Din të shfrytëzojë monedha dhe bankënota.</p> <p>Shfrytëzon fakte për mbledhje dhe zbritje deri 100 që ta llogarit kusurin.</p> <p>Zgjedh dhe shfrytëzon njësi</p>	<p>Shumë prej këtyre aktiviteteve veprojnë si përforcim e të mësuarit të mëparshëm. Ndërrojeni kontekstin nëse është adekuat ose ndërrojeni vlerën e të hollave, ose ndërroni pyetjet kur shfrytëzoni vëllim dhe masë që ti bëni pyetjet me te përbëra, ose bëni pyetjet si problem që do të zgjidhen në dy etapa.</p> <p>Shfrytëzoni cilëndo prej 4 – operacioneve për zgjidhje të problemeve me ‘tregimin’ i cili përfshin të holla (tregtim, shkuarje në bankë.....) të marra nga jeta reale, duke diskutuar kur duhet të shfrytëzojmë të holla. Vendosije e situatave nga jeta reale në klasë.</p> <p>Ndërroni bankënotë për vlerën e saj ekuivalente në bankënote më të vogla ose monedha.</p> <p>Me luajtje të roleve me gojë sqaroni metodat dhe të menduarit dhe, derisa është adekuate, shënoni shprehje numerike që të tregoni si ka qenë zgjidhur problem.</p> <p>Zgjidhni dhe shfrytëzoni pajisje të ndryshme për matje : vizore, peshore,</p>	<p>Mbishkrime ose letra të cilat tregojnë notacion. Qoshk në klasë. Të holla të vërteta.</p> <p>Të holla të vërteta. Probleme të cilat nxënësit do ti zgjidhin.</p>	<p>Disa nxënës ndoshta do te duhet ti realizojnë këto aktivitete me qëllim që ti mbështesin njohuritë e tyre, aftësitë dhe të kuptuarit. Tjerët mund ti shfrytëzojnë si përkujtim të njohurive nga vitet e mëparshme dhe të vazhdojnë me zgjidhjen e detyrave më të përbëra. Çdo here kur është e mundur, më së miri është kur nxënësit mund të ballafaqohen me situatë nga jeta reale, me përdorim të parave të vërteta. Fusha e lojës me role mund të jetë shumë e vogël (në tavolinë) dhe nuk do të merr shumë vendosje.</p>



Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>përkatëse dhe instrumente për vlerësim, matje dhe shënim të rezultateve nga matjet.</p> <p>Njohja e lidhjes ndërmjet kilometrave dhe metrave, metra e centimetra, kilogram e gram, litra e mililitra.</p> <p>E lexon ndarjen më të afërt, duke shfrytëzuar instrumente të matjeve të numëruar ose pjesërisht të numëruar</p> <p>Shfrytëzon vizore të vizatoj dhe matë vija deri te centimetri më i afërt.</p>	<p>lenta, bokall, menzura ... Shfrytëzoni vijë për matje dhe vizatoni vijë deri te gjysma me e afërt „cm“. Lexoni shkallë deri te ndarja më e afërt e shënuar në vizore, peshore ose bokall. Shënoni vlerësimet dhe matjet me zbatim të njësive të ndryshme .</p> <p>Të dihet se 1 kilometër = 1000 metra 1 metër = 100 centimetra 1 kilogram = 1000 gram 1 litër = 1000 mililitra Parashtroni pyetje ku përgjigja mundet te jepet me përdorim të njësive matëse relative dhe përkatëse.</p> <p>Mundësoni nxënësve të lexojnë shkallë deri te ndarja më e afërt. Kjo mund të bëhet praktikisht ose nëpërmjet letrave me foto dhe letra për lexim. Pasi nxënësit të fitojnë siguri, jepni vetëm letra me ngjyrë dhe kërkoni me fjalë të veta të lexojnë.</p> <p>Lidhje me situatë nga jeta reale: Shembull: matet gjatësia e një libri, lartësia e një tavoline. Bëni 2D vizatime ose 3D modele ku gjatësia e secilës brinjë matet me centimetra të plota dhe gjysmë</p>	<p>Pajisje e ndryshme për matje.</p> <p>Letra të ngjitura.</p> <p>Letra me foto.</p> <p>Letra për lexim.</p>	<p>Shfrytëzoni komplete prej letrave të ngjitura ku përgjigja e pyetjes së mëparshme shpie deri te pyetja vijuese: Unë kam 500 metra/ i cili ka gjysmë kilometër? Duhet te ketë mjaft letra që secili anëtarë i klasës ose 1 deri 2 nëse punohet në çifte.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>Zgjidh problem tekstuale në të cilat përfshihen matje.</p> <p>Propozon dhe shfrytëzon njësi përkatëse për matje të kohës dhe e din raportin ndërmjet tyre (sekonda, minuta, orë, ditë, javë, muaj, vit).</p> <p>E lexon Kohen analoge dhe digjitale, deri me se afërmi 5 minuta në orë analoge dhe minute më të afërt në</p>	<p>centimetra.</p> <p>Paramendoni tregime që përfshijnë të holla, gjatësi, masë ose vëllim. Fëmijët i zgjidhin problemet dhe paramendojnë detyra të veta tekstuale që i diskutojnë me nxënësit në paralele.</p> <p>Të dihet se 1 vit = 365 ditë ose 52 javë ose 12 muaj  1 javë = 7 ditë  1 ditë = 24 orë  1 orë = 60 minuta  1 minutë = 60 sekonda</p> <p>Të shfrytëzohet kalendar. Saktë ta shënojnë datën. Të dinë dhe të munden ta shënojnë datën e vet të lindjes. Parashtroni pyetje:  Si do ta matim Kohen të nevojshme për një udhëtim?  Çka do të përdorni që ta matni kohën prej një ditëlindje deri te tjetra ditëlindje?</p> <p>Me zbatim të orëve digjitale dhe analoge, të gjinden mënyra të ndryshme të tregoni Kohen e njëjtë si: 7.45 ose 45 minuta pas 7 ose 15 minuta deri në 8.  Lidhni me kohë digjitale.  Propozoni njësi kohore përkatëse që ta matni Kohen si (për shembull: ta hani shujtën e juaj, te përgatiteni për krevet,</p>	<p>Vizore.</p> <p>Lenta për matje.</p> <p>Letra të ngjitura.</p> <p>Kalendarë.  Ditarë.  Orare të ngjarjeve.</p>	<p>Kjo mund të bëhet si aktivitet në tërë paralelen e cila me pastaj mund të vazhdojë si punë në çifte ose grup, duke nxitur diskutim.</p> <p>Shfrytëzoni pyetje të hapura. Matja e një rrugëtimi mund të zbatohet. Rrugëtimi në dhomë do të ishte matur në minuta, por rrugëtimi në vend tjetër do të ishte matur me orë.</p> <p>Shfrytëzoni letra të ngjitura për kohë, edhe analoge edhe digjitale.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materiale)	Komente
<p>orë digjitale.</p> <p>Fillon të njehsojë intervale të thjeshta kohore në orë e minuta.</p> <p>Lexon kalendar dhe njehson interval kohore në javë dhe ditë.</p>	<p>te udhëtoni për shkollë ...). Fitoni ide prej nxënësve.</p> <p>Lidhni me njësitë për masë për kohën.</p>		

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materijale)	Komente
<p><b>Zgjidhje e problemeve</b></p> <p>Zgjedh dhe zbaton strategji përkatëse të të menduarit për njehsim.</p> <p>Fillon ti kuptojë njësitë matëse për gjatësi, peshë, vëllim dhe kohë dhe i shfrytëzon të kryejë matje përkatëse.</p> <p>Vlerëson dhe përcakton vlerën e përafërt dhe e provon rezultatin.</p> <p>Bën vlerësim të arsyeshëm të përgjigjes, shembull : me rrumbullakim. Përcakton a është përgjigja e arsyeshme.</p> <p>Paramendon tregim për detyrë të parashtruar, duke i përfshi në atë kontest edhe të hollat.</p>	<p>Shfrytëzoni strategji të të menduarit që të zgjidhni problem me matjet në numër të madh të kontesteve. Me gojë sqaroni metodat dhe të menduarit dhe ku është shprehja numerike adekuate që të tregoni se si është zgjidhë problem.</p> <p>Shfrytëzoni aktivitete praktike që ti rrisni njohuritë, aftësitë dhe të kuptuarit.</p> <p>Vlerësoni, pastaj provoni: moshën e fëmijës me te vjetër në shkollën tuaj . shfrytëzoni vite , muaj (dhe ditë atje ku është adekuat); sa gjatë flini natën; Sa kohë është e nevojshme të arrini në shkollë. Kërkoni nga nxënësit të japin ide tjera.</p> <p>Zbatim me para si dhe me masa tjera. Pyetni 'Sie fitove atë? Çka të ndihmoi? Çka ishte e rëndë? A do ta ndërrosh vlerësimin tënd? Pse?</p> <p>Luajtje rolesh, shembull „treg “ Isha të tregtoj, por qullë mjaft të holla vetëm për 2 punë Bleva mollë dhe dardhë. Sa para kam pasur? Beni tregimet me te përbërë sipas mundësisë.</p>	<p>Matje praktike e resurseve.</p>	<p>Puna praktike ndihmon në kuptim.</p> <p>Kërkesat nga nxënësit të japin ide të veta mund ta rritë të kuptuarit e tyre në detyrë.</p>

Qëllimet e të mësuarit	Aktivitete	Resurse (mjete dhe materijale)	Komente
E sqaron zgjedhjen e strategjisë për zgjidhjen e problemit dhe tregon se si ka ardhur deri te rezultati.	Luaj lojë. Kur tregtoni, mundet të shënohet çka keni blerë dhe sa ka kushtuar ajo. Mundet të shfrytëzoni lista dhe tabela për njehsim më preciz.		

### 3. Vlerësimi i të arriturave të nxënësve

#### *PROVA DHE VLERESIMI DIJAGNOSTIK*

Në fillim të viti shkollorë arsimtari bën prove dhe vlerësim diagnostikim me qëllim ta njohë situatën ashtu siç është, në funksion të planifikimit kualitativ dhe realizimit të aktiviteteve të ardhshme. Njihen njohuritë paraprake në kuptim të plotë të fjalës, aspektet socializuese të zhvillimit, zhvillimi emocional dhe zhvillimi fizik.

*VLERESIMI FORMATIV* – Gjatë mësimit nga matematika në klasën e tretë preferohet vlerësimi formative e cila përfshin punim dhe përcjellje të përmbledhjes së vërtetimeve të nxënësve që përfshin:

- mbledhje të treguesve (punime fëmijësh, punime gjykime e të ngjashme.) për çdo nxënës në veçanti;
- rrjedhëse (formative), ma pare të përgatitura, lista evalvuese për çdo nxënës, të cilat plotësohen pas aktivitetit të tij konkret, e cila është specifike (pozitive ose negative) ose studime rasti në të cilën arsimtari e shënon gjendjen faktike;
- instrumente të cilat i përkasin secilës hapësirë programore në veçanti dhe në të cilat arsimtari vë **të dhëna për të arriturat e nxënësit ndaj të gjitha aspekteve zhvillimore** të cilat nxiten me programin nga matematika (kognitivo-intelektual, socio-emocional dhe aspekti psikomotorik). Listat evoluese *primare i takojnë qëllimeve të cilat plotësisht arrihen në nivelin e klasës së tretë dhe nuk janë kaluese për klasat tjera me te larta.*

*VLERESIMI MIKROSUMATIV* – Në fund të tremujorit të dytë, në bazë të njohurive nga vlerësimi formativ, u realizua vlerësimi mikrosumativ.

*VLERESIMI SUMATIV* – Në bazë të të dhënave sumative të marra nga përcjellja dhe vlerësimi formative arsimtari konstaton (përshkruan gjendjen zhvilluese të secilit nxënës veç e veç, në kuadër të secilës fushë programore.

#### *QASJA DHE RRJEDHJA EPERMBLEDHJES SE VERTETIMEVE*

- Përmbledhja e vërtetimeve duhet, gjatë tërë vitit, të jete e hapur për prindërit që të mundën të kontribuojnë në Realizimin kualitativ të mësimit të matematikës.
- Nota përfundimtare analitiko-përshkruese dërgohet, gjithashtu, deri te prindërit dhe behet pjesë e përmbledhjes të vërtetimeve të nxënësit.
- Përmbledhja e vërtetimeve të nxënësit me të dhëna të pastra dhe të selektuara vazhdon edhe në klasat vijuese me te larta.

*MENYRA E PROVES DHE VLERESIMIT* – Sipas natyrës se programit nga matematika ne klasën e tretë, provimi dhe nota përshkruese duhet të realizohen me gojë, *praktikisht, nëpërmjet prezantimit dhe ushtrime përkatëse dhe aktivitete.*

#### **4. Kushte hapësinore për realizim të programit**

Programi sipas kushteve hapësinore për realizim bazohet në Normativ për hapësire për klasën e I,II dhe III dhe në mjetet mësimore për klasën e III te sjellë nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.

#### **5. Normativ për kuadër arsimor**

Mësimin e matematikes në klasën e tretë mundet ta realizojë:

- Profesor për mësim klasorë;
- Pedagog i diplomuar.

## Nënshkrim dhe datë e përcaktimit të programit mësimor

Programi mësimor nga matematika *për klasën e tretë* të arsimit fillor nëntëvjeçar, e marrë dhe e lejuar nga qendra ndërkombëtare për programe mësimore ( Cambridge International Examination) dhe e adaptuar nga Byroja e zhvillimit të arsimit, e verifikoi

Më datë

Ministri

---

Spiro Ristovski